



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

**Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për
Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020**

Prishtinë, mars 2024

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 30001¹).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020” në konsultim me Ndhmës Auditoren Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e realizoi këtë raport:

Fatlinda Ramosaj, Drejtor i auditimit;

Vjosë Bojku, Udhëheqës i ekipit;

Lirak Mulliqi, Anëtarë i ekipit; dhe

Vjosa Zeqiraj, Anëtare e ekipit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa: Lagja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 (0) 38 60 60 04

<http://zka-rks.org>

¹ Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

² Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

³ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁴ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	i
1 Hyrje	1
2 Objektiva e auditimit dhe pyetjet e auditimit.....	2
Pyetjet e auditimit.....	2
3 Gjetjet e auditimit.....	3
3.2 Dokumenti i treguesve të raportuar nga komunat për Performancë Komunale	4
3.2.2 Transparenca komunale.....	4
3.1.2 Planifikim Hapësinor	5
3.1.3 Infrastruktura rrugore.....	6
3.1.4 Parkingjet Publike.....	6
3.1.5 Uji i Pijshëm.....	7
3.1.6 Kujdesi Primar Shëndetësor.....	7
3.1.7 Zhvillim Ekonomik Lokal.....	8
3.2 Dokumentimi i treguesve nga komunat për Grant të Performancës Komunale.....	9
3.2.1 A ka vlerësuar MAPL si duhet treguesit e raportuar nga komunat?	12
3.2.2 Vlerësimi i treguesve nga MAPL-ja për Grantin e Performancës Komunale	17
3.2.3 Gjendja faktike e treguesve në terren.....	19
4. Konkluzionet	25
5. Rekomandimet	26
Shtojca I	27
Kriteret e auditimit	27
Fushëveprimi i auditimit	27
Metodologjia e auditimit	28
Problemi i auditimit.....	29
Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant.....	30
Shtojca II Vlerësimi sipas MAPL-së dhe ZKA-së.....	31
Shtojca III Tabela e poentimit të treguesve të GPK-së.....	34
Shtojca IV Vlerësimi i Performancës Komunale nga komunat, MAPL-ja dhe ZKA-ja37	
Shtojca V Letër konfirmimet	41
Shtojca VI Komentet e Komunës së Obiliqit	45

Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
DEMOS	Decentralization and Municipal Support
LPP	Ligji për Prokurim Publik
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SIMPK	Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale
SP	Sekretari i Përgjithshëm
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën “Procesi i Dokumentimit, Vlerësimi dhe Verifikimi në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020’. Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësoj funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale, përkatësisht procesi i raportimit dhe dokumentimit të treguesve nga komunat: Skenderaj, Obiliq, Gjilan dhe Graçanicë. Po ashtu kemi vlerësuar se si është bërë verifikimi dhe vlerësimi i këtij dokumentimi nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Rezultatet tona të auditimit tregojnë që komunat e audituara në përgjithësi nuk kanë dokumentuar treguesit e performancës komunale me dokumente mbështetëse. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kishte kryer vlerësimin, megjithatë nuk ka respektuar të gjitha rregullat e vlerësimi, sidomos kërkesën lidhur me verifikimin fizik në terren. Një vlerësim ad hoc i treguesve në terren nga Ministria është kryer pas vlerësimi të performancës komunale, mirëpo me të gjitha mangësitë e identifikuara ky vlerësim nuk ka ndikuar në rezultat në renditjen finale të komunave përfituese. Mangësitë ekzistuese në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale zbehin besueshmërinë e përzgjedhjes së përfituesve dhe dekurajon komunat që t’i përgjigjen në mënyrë efektive kërkesave të këtij sistemi.

Nga 38 komunat në Republikën e Kosovës, 14 prej tyre kanë përmbushur kushtet minimale dhe janë kualifikuar për grantin e performancës komunale për vitin 2022. Shuma e Grantit të Performancës Komunale e ndarë për vitin 2022 ishte tetë milion euro.

Komunat nuk kanë mbështetur treguesit e raportuar me dëshmi relevante. Komunat e audituara kanë ndjekur praktika të ndryshme në bashkëngjitjen e dëshmimeve të cilat jo çdo herë ishin në përputhje me dokumentet që i kërkonte Dokumenti Kryesor si dëshmi relevante. Komunat e audituara kishin vendosur dokumente të ndryshme. Në rastin e Komunës së Obiliqit pjesa më e madhe e treguesve janë mbështetur me raportin vjetor të Kryetarit të Komunës, në rastin e Komunës së Gjilanit një pjesë e konsiderueshme e treguesve janë mbështetur me dokumente të pavulosura dhe pa protokolluara, në rastin e Skenderajt kishte dokumente që nuk përkonin me kërkesat e treguesve dhe Dokumentit Kryesor, ndërsa në Graçanicë ishte vendosur vetëm numri i protokollit të dokumentit dhe data por nuk kishin bashkëngjitur dokumentin që iu janë referuar. Pra mbështetja e treguesve nuk ishte bërë me dokumente relevante dhe sipas kërkesave të treguesve.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kishte poentuar komunat në bazë të rezultateve që kishin raportuar vetë komunat në performancën komunale. Në katër komunat e audituara kemi vërejtur që MAPL-ja ka poentuar disa fusha respektivisht tregues me numër të njëjtë të pikëve edhe pse ato kishin bashkëngjitur dokumente të ndryshme për treguesin e njëjtë. Treguesit e performancës komunale gjatë raportimit duhet të dokumentohen me dëshmi të njëjtë në secilën komunë.

Vlerësimi jo i drejtë i performancës komunale ka ndikuar automatikisht edhe në vlerësimin, respektivisht rezultatin e GPK-së. Gjatë vlerësimi se si dokumentimi është bërë, MAPL-ja nuk ishte mjaftueshëm e vëmendshme në të dyja ciklet e vlerësimi, si të performancës komunale e po

ashtu edhe të GPK-së. Ajo nuk ishte siguruar që komunat kishin mbështetur deklarinimin e tyre me dëshmi relevante dhe as nuk kishte bërë vizita në terren për të verifikuar këto raportime. Në vitin 2020 kishte bërë një praktikë të vlerësimit të treguesve në terren, por që ky vlerësim nuk kishte ndikim në rezultatet e GPK-së, pasi që ishte bërë me vonesë, pra pas kohës së rregullt të vlerësimit të performancës komunale.

Me qëllim të adresimit të këtyre çështjeve me rëndësi kemi dhënë gjithsej shtatë rekomandime, dy prej tyre për komunat dhe pesë prej tyre për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Lista e plotë e rekomandimeve për Ministrinë është paraqitur në kapitullin pesë të këtij raporti.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe tri Komunat: Skenderaj, Graçanicë dhe Gjiilan janë pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet e raportit të auditimit, letër konfirmimet gjenden në shtojcën V. Komuna e Obiliqit nuk është pajtuar me të gjitha gjetjet, prandaj komentet e tyre gjenden në shtojcën VI. Inkurajojmë institucionet e përfshira në këtë auditim që të bëjnë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Vlerësimi i performancës komunale është një proces i cili nënkupton matjen sa më të drejtë të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e një komune. Ky proces në Republikën e Kosovës rregullohet dhe monitorohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (tutje MAPL), ndërsa deklarues të informatave lidhur me performancën komunale janë vetë komunat.

Edhe pse sistemi i raportimit të performancës komunale nga viti në vit është zhvilluar, matja e performancës dhe saktësia e informatave mbetet sfidë për institucionet e nivelit lokal për këto raportime.

Rëndësia e matjes së performancës komunale qëndron në faktin se është mjet kyç që u mundëson komunave të fitojnë grant. Ky grant është një ndër programet kryesore të MAPL-së përmes së cilit komunat arrijnë të fitojnë projekte bazuar në performancën e tyre vjetore.

Zyra Kombëtare e Auditimit (tutje ZKA) në vitin 2013 për herë të parë ka publikuar dokumente diskutimi mbi performancën financiare dhe jo-financiare në fusha të caktuara të qeverisjes lokale. Rezultatet e dala nga këto analiza thirren të shërbejnë si një matës dhe instrument vetë-kritik për përdorimin sa më racional të fondeve publike.

Pastaj, në vitin 2016 dhe 2017, ZKA ka publikuar dy raporte të auditimit që kishin fokus dhe fushëveprim treguesit e performancës komunale, përkatësisht Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale (tutje: SMPK).

Zyra Kombëtare e Auditimit nga viti 2018 ka filluar bashkëpunimin me Helvetas. Katër auditimet e publikuara si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi kishin për qëllim vlerësimin se si komunat përfituese kishin zhvilluar procedurat e prokurimit, menaxhuar kontratat, a kishin përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve dhe menaxhimin e projekteve në përgjithësi. Përveç këtyre, në auditimin e katër është vlerësuar edhe ndikimi apo menaxhimi i granteve si tërësi dhe dallimet mes pjesës së financimit nga Donatorët dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Qëllim i raportit të parë ishte dhënia e rekomandimeve që do të ndikonin në përmirësimin e mëtejshëm si dhe krahasimi midis komunave, në mënyrë që të rritet llogaridhënia mbi menaxhimin e parasë publike kundrejt shërbimeve që komunat u ofrojnë qytetarëve. Ndërsa raporti i dytë paraqet vlerësimin që i është bërë mënyrës së funksionimit të SMPK-së në përgjithësi, e me fokus të veçantë në procedura dhe kontrolle për të konstatuar nëse sistemi prodhon të dhëna të SMPK i cili është instrument për vlerësimin e performancës së komunave bazuar në fusha, tregues dhe të dhëna.

Rëndësia e këtij sistemi qëndron në lidhjen që krijon sistemi mes komunave dhe MAPL-së me qëllim ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave për fushat dhe treguesit e raportuar. Për më tepër, verifikimi i sistemit të raportimit të performancës komunale jo vetëm që është një element kritik i vetë vlerësimit të komunave, por gjithashtu është kërkesë specifike e MAPL-së, e cila synon të sigurojë që qeverisja lokale operon në përputhje me standardet më të larta të transparencës dhe llogaridhënies.

Në vazhden e iniciativave për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj tatimpaguesve dhe palëve tjera të interesit, ZKA ka vendosur të bëjë këtë auditim. Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi nëse performanca komunale është pasqyruar drejtë.

2 Objektiva e auditimit dhe pyetjet e auditimit

Përmes këtij auditimi, ne kemi vlerësuar funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale. Pra, është vlerësuar se si ka funksionuar procesi i raportimit dhe dokumentimit të treguesve nga komunat: Skenderaj, Obiliq, Gjilan dhe Graçanicë. Po ashtu kemi vlerësuar se si është bërë verifikimi dhe vlerësimi i këtij dokumentimi nga ana e MAPL.

Pyetjet e auditimit

Për t'ju përgjigjur objektivës së auditimit, ne kemi parashtruar pyetjet në vijim:

1. A janë raportuar si duhet treguesit e performancës komunale nga komunat e caktuara?
2. A i ka vlerësuar si duhet MAPL-ja treguesit e performancës dhe a e ka verifikuar gjendjen faktike të tyre në terren?

Ky auditim ka mbuluar procesin e vlerësimit të performancës për vitin 2020, vlerësim i kryer në fillim të vitit 2021, ndërsa mjetet janë ndarë gjatë vitit 2022. Në këtë auditim kemi mbuluar katër komuna: Gjilanin, Obiliqin dhe Graçanicën si përfituese të Grantit të Performancës Komunale për vitin 2020. Përzgjedhja e këtyre komunave është bërë bazuar në shumën e grantit të ndarë, numrin e popullsisë dhe madhësinë e komunës për nga territori në mënyrë që mostra të jetë përfaqësuese, pra një komunë të madhe, një të mesme dhe një të vogël. Ndërsa Komunën e Skenderajt e kemi përzgjedhur si një komunë e cila ishte radhitur e para në vlerësimin e performancës komunale por nuk kishte arritur që të fitoj mjete nga ky grant, për faktin se nuk kishte plotësuar kushtin që të ketë të shpenzuara 75% të buxhetit për investime kapitale e që ky është një nga kushtet minimale për t'u kualifikuar si përfituese e grantit.

Metodologjia e detajuar e aplikuar gjatë këtij auditimi, nën-pyetjet e auditimit kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në Shtojcën I.

3 Gjetjet e auditimit

Për të raportuar performancën komunale, komunat kanë në dispozicion 45 ditë kalendarike apo 32-33 ditë pune, nga momenti i thirrjes publike. Ky raportim përfshinë 19 fusha me 119 tregues dhe këta tregues duhet mbështetur me 343 të dhëna. Ky proces i raportimit kalon disa hallka komunikimi: fillimisht zyrtari për performancë komunale raporton, pastaj koordinatori bënë verifikimin dhe hallka e fundit është autorizimi nga kryetari i komunës dhe të gjitha këto hallkat duhet të kalohen për këtë kohë.

Për të analizuar këtë proces, kemi audituar shtatë⁵ prej 19 fushave apo rreth 40% të tyre. Po ashtu kemi audituar se si MAPL ka vlerësuar treguesit që janë të caktuar për ndarjen e GPK-së edhe në kontekstin e dokumentimit.

Shuma e përgjithshme për grantin e performancës komunale për vitin 2022 ishte tetë milionë euro. 14 nga 38 komunat e vlerësuara i kishin përmbushur katër kushtet minimale dhe ishin përfituese të grantit të performancës komunale për vitin 2022. Nga këto 14 komuna, tetë ishin financuar nga MAPL. Kjo do të thotë që 36.84% e komunave në Kosovë ishin përfituese⁹ të këtij granti në vitin 2022, qoftë nga financimi i bërë nga MAPL apo edhe nga Donatorët. Vlera e financuar e grantit për vitin 2022 nga MAPL ishte tre milion euro.

	Komunat e financuar nga MAPL për vitin 2022	Shuma e Grantit të ndarë në Euro (€)
1.	Gjilan	864,306
2.	Obiliq	808,141
3.	Pejë	761,187
4.	Kaçanik	306,057
5.	Han i Elezit	82,555
6.	Graçanicë	81,661
7.	Mitrovicë e Jugut	61,367
8.	Shtërpçë	34,726
		3,000,000

⁵ Transparenca Komunale, Planifikimi Hapësinor, Infrastruktura Rrugore, Parkingjet Publike, Uji i Pijshëm, Kujdesi Primar Shëndetësor dhe Zhvillimi Ekonomik.

3.1 Dokumenti i treguesve të raportuar nga komunat për Performancë Komunale

Dokumentimi i treguesve është një nga proceset kryesore të performancës komunale kjo pasi që si rezultat i dokumentimit të duhur të këtij procesi dhe pasqyrimin të drejtë të performancës komunale, komunat vlerësohen dhe shpërblehen me fonde.

Në vijim janë paraqitur shtatë fushat e audituara lidhur me procesin e dokumentimit të performancës komunale.

Transparenca komunale

Treguesit e kësaj fushe për të cilët komunat raportojnë janë: mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt, nivelin e qasjes në dokumente publike nga qytetaret, përmbushjen e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës, publikimin e akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës, publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës në faqen zyrtare të komunës, publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit dhe publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave.

Transparenca komunale është fusha e dytë e vlerësimit të performancës komunale. Kjo fushë i referohet pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në organet komunale. Ky proces përfshinë qasjen e qytetarëve në mbledhjet e kuvendit komunal dhe të komisioneve të tij, mbledhjeve të institucioneve komunale me publikun si dhe detyrimeve të komunave që të informojnë dhe konsultojnë publikun gjatë zhvillimit të akteve komunale. Në rastet kur komuna nuk mund të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, ajo krijon mekanizma të përshtatshëm për t'i informuar ata për punën e organeve komunale, nëpërmjet qasjes në dokumente fizike publike apo qasjes në dokumente elektronike⁶.

Sa i përket transparencës komunale, në Komunën e Obiliqit, nga shtatë treguesit e matjes së performancës komunale për këtë fushë tre⁷ prej tyre nuk ishin të mbështetur me dëshmi relevante. Në treguesin 2.2.1 (mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online) nga katër raportet financiare të kërkuara të cilat duhet të diskutohen në kuvendin komunal, komuna kishte bashkangjitur vetëm njërin prej tyre ndërsa në dy treguesit të cilët kishin referencë ueb faqen e komunës nuk ishin të qasshëm.

⁶ <https://zka-rks.org/ep-content/uploads/2017/11/Procedurat-dhe-kontrollet-n%C3%AB-SMPK-1.pdf>

⁷ Treguesi "mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online", ka raportuara se janë mbajtur 15 e në fakt ishin vetëm 9;

Treguesi "niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetaret" nuk është bashkangjitur dokumenti relevant.

Treguesi "përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës" e dhëna 3 ku kërkohet informata në formë të tabelës lidhur me të gjitha lejet dhe licencat ekzistuese që janë lëshuar, revokuar ose pezulluar nga institucioni publik, në kërkesë është bashkangjitur plani i punës dhe të dhënat janë paraqitur të përgjithshme por nuk janë specifikuar siç janë kërkuar në kriter (f.53) ndërsa e dhëna 4, ku ka informata të hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun është pjesërisht e dokumentuar pasi që kërkesa lidhur me certifikatën, autorizimet dhe vërtetime apo shërbime publike të tjera nuk janë e qasëshme në faqen zyrtare të Komunës.

• Treguesi "Buxheti i miratuar vjetor" dëshmia e bashkangjitur nuk është relevante;

Në Komunën e Gjilanit, nga shtatë treguesit të performancës⁸ komunale pesë prej tyre nuk janë të mbështetur me dëshmi relevante. Për më shumë, dokumentet në këtë fushë të bashkangjitura ishin në Microsoft Word, format i cili nuk vërteton pjesëmarrësit dhe kohën e saktë të raportimit, ndërsa në dy prej treguesve të tjerë dokumentet nuk janë në dispozicion në faqen zyrtare elektronike të komunës.

Në Komunën e Skenderajt, nga shtatë treguesit e performancës komunale edhe pse të gjithë treguesit ishin të mbështetura me dëshmitë relevante për këtë fushë në format PDF, për dy nga të dhënat në linkun e komunës nuk janë të qasshme.

Në Komunën e Graçanicës, nga shtatë treguesit kemi gjetur se dy prej tyre nuk ishin mbështetur me dëshmi të vlefshme pasi që komuna kishte vendosur dokumente të pa vulosura dhe të pa protokolluara. Katër prej tyre ishin të mbështetur pjesërisht, ku për këta tregues komuna ka bërë njoftimin publik lidhur me mbledhjet e kuvendit komunal mirëpo nuk janë publikuar në faqen elektronike të komunës mbledhjet e mbajtura drejtpërdrejtë, ashtu siç kërkohet

3.1.2 Planifikimi Hapësinor

Kjo fushë përbëhet nga katër tregues për të cilët kërkohet që komunat të raportojnë dhe të prezantojnë dëshmitë relevante në faqen zyrtare të komunës. Komunat raportojnë se sa përqind e territorit të komunës është e rregulluar me plane rregulluese (të hollësishme), kërkesat e shqyrtuara për leje të ndërtimit, ndërtesa të reja të inspektuara dhe objekte të reja me leje ndërtimi.

Planifikimi hapësinor është fusha e shtatë e vlerësimit të performancës komunale dhe si e tillë nënkupton zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor si: Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme për të siguruar veprimtarinë e jetës institucionale dhe shoqërore në mënyrë të organizuar.

Në Komunën e Obiliqit, nga katër treguesit e kësaj fushe, njëri nga ta nuk është në dispozicion në faqen zyrtare elektronike të komunës (përveç dëshmisë për hartën zonale e cila nuk mund të ngarkohet në sistem), ndërsa kërkesat e tjera nuk janë të mbështetura me dëshmi relevante. Për më shumë, për tre treguesit tjerë është bashkangjitur vetëm raporti vjetor i kryetarit të komunës edhe pse nuk është dokument relevant.

Në Komunën e Gjilanit, tek treguesi i parë janë bashkangjitur dëshmi jo relevante në sistem, ku nga këto nuk mund të vërtetohet saktësia e sipërfaqes së Komunës. Tek treguesi i dytë kemi vetëm një të dhënë pa dëshmi relevante ndërsa dy treguesit e tjerë janë të mbështetur me dëshmitë e duhura.

Në Komunën e Skenderajt, nga katër treguesit e kësaj fushe, vetëm njëri nga ta nuk ishte i qasshëm direkt në dëshmitë e ofruara nga komuna, kjo për shkak se dokumenti voluminoz i hartës zonale ishte i pa mundur të ngarkohet në sistem. Të gjitha dokumentet tjera janë të qasshme dhe relevante me kërkesat.

Në Komunën e Graçanicës, kjo fushë është e dokumentuar në secilin tregues.

⁸ Secili tregues ka tri burime të dhënave.

3.1.3 Infrastruktura rrugore

Kjo fushë kërkon që komunat të raportojnë se sa për qind e totalit të rrugëve në komunë janë të asfaltuara, sa prej tyre janë të asfaltuara për herën e parë, sa prej tyre mirëmbahen, sa kanë trotuare, ndriçim publik dhe sinjalizim horizontal dhe vertikal. Ky tregues duhet të dëshmohet me kontratë, faturë dhe pranim teknik të punëve të përfunduara. Kjo fushë përbëhet nga tetë tregues.

Infrastruktura rrugore lokale nënkupton rrugët komunale dhe infrastrukturën përkatëse përcjellëse (trotuaret dhe ndriçimin publik) që janë nën kompetencën e komunës.

Në asnjërën nga tri Komunat: Obiliq, Gjilan dhe Graçanicë, treguesit për infrastrukturën rrugore nuk ishin mbështetur me dëshmi relevante siç janë kontrata, fatura dhe pranimi teknik. Ndërsa në Komunën e Skenderajt, nga tetë treguesit katër prej tyre ishin mbështetur vetëm pjesërisht.

3.1.4 Parkingjet Publike

Ky tregues mbështetet me kontratat koncensionale të komunës me partnerët privat, raportet monitoruese të parkingjeve publike, regjistrave zyrtar për numrin e mjeteve motorike të regjistruara dhe të raporteve monitoruese të parkingjeve publike dhe numrin e parkingjeve publike të cilat kanë të rezervuar vend-parkim për mjetet motorike të personave me aftësi të kufizuar.

Hapësirat për parkim publik janë vende në pronësi publike dhe private, me një numër të caktuar të vendeve të parkimit, të ndërtuara me standardet e kërkuara dhe të caktuara për parkimin e mjeteve motorike. Për qëllim të matjes së performancës në këtë fushë, termi “publik” në kontekst të parkingjeve, nuk i referohet pronësisë, d.m.th. lokacionet apo parkingjet publike mund të jenë edhe në pronësi private dhe si të tilla të ofrojnë shërbime për publikun.

Komuna e Obiliqit – nga katër tregues dy i kishte mbështetur me dëshmi relevante. Treguesi 11.1.2 (krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike) dhe 11.1.3 (krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike) nuk e kishte të bashkangjitur asnjë nga dokumentet e kërkuara si: kontratë koncesionale të komunës me partner privat, leje të lëshuara për ofrimin e shërbimit të parkimit publik dhe regjistrat e mjeteve motorike.

Komuna e Skenderajt – nga katër tregues, tre i kishte mbështetur me dokumentet e kërkuara ndërsa treguesi 11.1.2 ishte i mbështetur pjesërisht, ku nga dy të dhëna në këtë tregues në njërën është bashkangjitur një raport financiar.

Komuna e Gjilanit – katër treguesit ishin të mbështetur me dëshmitë e duhura si kontrata e komunës me partner privat, lejet e lëshuara për ofrimin e shërbimit të parkimit publik dhe regjistrat e mjeteve motorike.

Komuna e Graçanicës – në këtë fushë nuk ka bashkëngjitur asnjë dokument si dëshmi lidhur me raportimin.

3.1.5 Uji i Pijshëm

Kjo fushë përbëhet nga dy tregues për të cilët kërkohet që komunat të raportojnë dhe të prezantojnë dëshmitë relevante në faqen zyrtare të komunës. Komunat raportojnë për realizimin e planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin ujit të pijshëm.

Uji i pijshëm është fusha e 12-të e vlerësimit të performancës komunale. Furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm është shërbimi më themelor që komuna është e obliguar ta ofroj për qytetarët e saj.

Komuna e Obiliqit, nuk kishte ofruar dëshmi relevante lidhur me kërkesat për asnjërin nga këta dy tregues të raportuar. Treguesi i parë nuk ishte specifik me numrin e projekteve, ndërsa treguesi i dytë ishte pjesërisht i mbuluar me dëshmi, kjo pasi që Komuna kishte bashkangjitur raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës pa referencat e faqeve përkatëse se ku ndodhen këto të dhëna.

Komuna e Gjilanit dhe Graçanicës këtë fushë e kishin mbështetur me të gjitha dëshmitë e raportuara sipas kërkesave të Dokumentit Kryesor.

Komuna e Skenderajt në treguesin e parë nuk kishte bashkangjitur kontratat për punët e kontraktuara siç kërkohet në këtë tregues, në vend të tyre kishte bashkangjitur planin e punës së ekzekutivit dhe planin e punës së urbanizmit.

3.1.6 Kujdesi Primar Shëndetësor

Kërkesat për fushën e kujdesit primar shëndetësor duhet të mbështeten me raportin e Agjencioni të Statistikave të Kosovës, saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga raporti vjetor i kryetarit të komunës, në seksionin për drejtorinë e shëndetësisë dhe raportin sektorial të drejtorisë së shëndetësisë.

Kujdesi Primar Shëndetësor është fusha e 18 e vlerësimit të performancës komunale në SMPK, ku Sistemi Shëndetësor në Kosovë është kryesisht publik. Shteti siguron pjesën më të madhe të shërbimeve që i ofrohen popullatës.

Në Komunën e Obiliqit – nga shtatë treguesit e performancës komunale në dy prej tyre Komuna nuk kishte bashkangjitur dëshmitë e duhura, pasi që kërkohet të bashkëngjiten raportet nga qendrat e mjekësisë familjare si dhe raportimet në inspektoratin shëndetësor. Pesë të tjerat ishin të mbështetura me dëshmi relevante me raportin e kryetarit të komunës dhe raportin e drejtorisë së shëndetësisë.

Komuna e Gjilanit – nga shtatë treguesit e performancës në fushën e kujdesit primar shëndetësor pesë prej tyre nuk ishin të mbështetur me dokumentet që kërkohen, dhe dy prej tyre ishin dokumentuar pjesërisht pasi ishte bashkangjitur raporti për SMPK 2021 i përgatitur nga drejtoria e shëndetësisë.

Komuna Skenderajt – nga shtatë treguesit në këtë fushë, vetëm tre tregues ishin mbështetur pjesërisht me dokumentet e kërkuara të dokumentuara me raportin të drejtorisë së shëndetësisë.

Komuna Graçanicës – nga shtatë treguesit e performancës në këtë fushë, gjashtë prej tyre nuk ishin mbështetur me asnjë dokument dhe njëri nga treguesit është raportuar me zero.

3.1.7 Zhvillim Ekonomik Lokal

Kjo fushë kërkon që komunat të raportojnë për planin për zhvillim ekonomik lokal, përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim, niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë dhe niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)

Në Komunën e Obiliqit, nga katër tregues tre prej tyre janë të mbështetur pjesërisht me dëshmi pasi që komuna kishte bashkangjitur vegzën elektronike të Administratës Tatimore mirëpo nuk kishte bashkangjitur edhe raportin e drejtorisë së tatimit në pronë. Treguesi i dytë 19.1.2 (Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim) nuk i ka të bashkangjitura dëshmitë relevante, në vend të listës së pronave për dhënie në shfrytëzim dhe publikimit të kësaj liste komuna ka bashkangjitur vegzën elektronike të komunës në të cilin nuk gjejmë dokumentet e kërkuara.

Në Komunën e Gjilanit, nga katër tregues dy tregues janë mbështetur pjesërisht me dokumente, kjo pasi që komuna ka bashkëngjitur vetëm planin për zhvillim ekonomik lokal, ndërsa nuk ka bashkangjitur planin e realizimit të zhvillimit ekonomik lokal, po ashtu mungon dëshmia e publikimit të listës së planifikuar për dhënie të pronave në shfrytëzim, ndërsa në dy tregues tjerë komuna ka bashkangjitur dokumente pa vulë dhe pa protokoll. Në Komunën Skenderajt, nga katër tregues njërin nuk e kishte mbështetur me dëshminë relevante ndërsa për treguesin tjetër linku nuk ishte në dispozicion në faqen zyrtare elektronike të Komunës. Ndërsa dy të tjerët ishin të mbështetur plotësisht me dëshmitë relevante.

Në Komunën e Graçanicës, nga katër tregues në dy prej tyre nuk ishte bashkangjitur asnjë dokument ndërsa dy të tjerat ishin raportuar me zero.

Shkaktarët për këtë pasqyrë të dokumentimit të treguesve të komunave janë:

- raportimi për herë të parë përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale;
- ndryshimet e shpeshta të zyrtarëve për performancë komunale;
- ndryshimin e koordinatorit për performancë komunale;
- mungesa e trajnimeve lidhur me deklarinimin për performancë komunale;
- pandemia COVID 19 pasi që në vitin 2020 kryesisht ishte punuar me staf esencial dhe jo të gjithë dokumentet ishin protokolluar e arkivuar ashtu siç kërkohet;
- mungesa e pajisjeve dhe sallës adekuate për mbajtjen e mbledhjeve dhe transmetimin e drejtë për drejtë të tyre.

Si pasojë e këtyre shkaktarëve komunat nuk kanë arritur të dokumentojnë në mënyrë të duhur procesin e performancës komunale, kjo pasi që nuk ishin mjaftueshëm të familjarizuar me kërkesat e sistemit elektronik të deklarimit të performancës komunale. Për më tepër ato në vazhdimësi kanë ndryshuar zyrtarët raportues për performancë komunale, ku në disa raste edhe ndryshimi i koordinatorit ka ndikuar që të mos ketë harmonizim të dokumentacionit relevant për të mbështetur secilën të dhënë. Gjetjet në lidhje me dokumentacionin jokonsistent, ndryshimet e shpeshta të

zyrtarëve raportues dhe mungesa e trajnimit në proceset e performancës komunale nxjerrin në pah sfidat e rëndësishme në sistemin aktual. Këto çështje mund të ndikojnë në shpërndarjen e grantit të performancës komunale duke komprometuar besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të raportuara. Mungesa e harmonizimit në dokumentacion dhe bashkëngjitja e dokumenteve të pavulosura dhe të paregjistruara mund të çojë në keqinterpretim të performancës aktuale të komunave. Për më tepër, raportimi zero për tregues të caktuar për shkak të mungesës së pajisjeve adekuate të regjistrimit gjatë vitit pandemik, nënvizon nevojën për mbështetje dhe burime shtesë.

Adresimi i këtyre sfidave është thelbësor për ndarjen e drejtë dhe efektive të grantit të performancës komunale, duke siguruar që fondet të ndahen në bazë të vlerësimeve të sakta dhe gjithëpërfshirëse të performancës komunale.

3.2 Dokumentimi i treguesve nga komunat për Grant të Performancës Komunale

Sipas Dokumentit Kryesor të Performancës Komunale vlerësimi për GPK bëhet në tri fusha: Qeverisja demokratike, Menaxhimi komunal dhe Ofrimi i shërbimeve. Këto tre fusha ndahen tutje në dhjetë nën-fusha siç paraqitet më poshtë në tabelë. Në kuadër të këtyre dhjetë nën-fushave, janë identifikuar 30 tregues të performancës për vlerësim (megjithatë në vitin 2020 janë vlerësuar vetëm 28, për shkak të pandemisë COVID 19), të cilët bashkërisht u mundësojnë komunave të marrin 100 pikë në vlerësimin e performancës.

Komunat duhet të përdorin dokumentacionin standard për regjistrimin dhe raportimin e secilit tregues sipas Dokumentit Kryesor për Raportimin e Performancës Komunale⁹, ku për secilin tregues është i specifikuar se cilat dokumente duhet të bashkëngjiten si burim i të dhënave.

Në tabelën 1, kemi paraqitur 28 treguesit e vlerësuar nga MAPL-ja për vitin 2020 në kontekstin e dokumentimit të secilit tregues. “Jo” (e paraqitur me ngjyrë të kuqe në tabelë) paraqet dokumentim jo të saktë të bashkëngjitur nga komunat, “pjesërisht” paraqet dokumentim jo të plotë të raportuar për treguesit nga komuna dhe “zero” janë treguesit që nuk janë raportuar fare. Të dhënat e pa qasshme janë treguesit në të cilat ZKA-ja nuk kishte qasje për ti vlerësuar, ndërsa treguesit e ngrirë ishin treguesit që nuk janë vlerësuar fare nga MAPL-ja për shkak të pandemisë COVID 19.

Në tabelën 1 kemi paraqitur dokumentimin e secilit tregues në katër komunat e audituara.

Përgjegjshmëria Komunale	Obiliq	Skenderaj	Gjilan	Graçanicë
I. Roli I kuvendit komunal si organ mbikëqyrës				
Treguesi: 3.2.1	Jo	Po	Jo	Po
Treguesi : 3.2.2	Pjesërisht	Jo	Jo	Jo
Treguesi : 3.2.3	0	Po	0	0

⁹ Dokumenti Kryesor i Performancës Komunale nga fq.62-291

Treguesi : 3.2.4	Jo	Po	Jo	Pjesërisht
Treguesi : 3.2.5	0	Jo	Jo	Jo
Treguesi : 3.2.6	Pjesërisht	Pjesërisht	Jo	Pjesërisht
II. Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve				
Treguesi : 3.1.2	Pjesërisht	Po	Jo	Pjesërisht
Treguesi : 3.1.3	Jo	Po	Jo	Jo
Treguesi : 3.1.4	Po	Po	Jo	Po
III. Transparenca, qasja në informata dhe integriteti				
Treguesi : 2.1.1	Pjesërisht	Po	Jo	Të dhëna të pa qasshme
Treguesi : 2.1.3	Pjesërisht	Po	Të dhëna të pa qasshme	Pjesërisht
Treguesi : 2.2.2	Po	Po	Po	Pjesërisht
Treguesi : 3.1.5	0	Po	Jo	Po
Treguesi : 3.4.1	0	Po	0	0
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNj				
IV. Menaxhimi Financiar				
Treguesi : 19.1.3	Të dhëna të pa qasshme	Po	Jo	Po
Treguesi : 19.1.4	Pjesërisht	Pjesërisht	Jo	Pjesërisht
Treguesi : 3.3.3	Pjesërisht	Pjesërisht	Jo	Pjesërisht
V. Menaxhimi i Kontratave				
Treguesi : 3.3.1	Po	Po	Jo	Po
Treguesi : 19.1.2	Të dhëna të pa qasshme	Jo	Pjesërisht	0
VI. Menaxhimi i burimeve njerzore				
Treguesi : 16.1.2	Jo	Po	Pjesërisht	Jo
Treguesi : 16.1.3	Pjesërisht	Po	Pjesërisht	Jo
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE - Qasja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve - Sipas sektorit				
VII. Shërbimet administrative				
Treguesi 1.1.2	Po	Po	Po	Jo
Treguesi : 15.1.2	Të dhëna të pa qasshme	Po	Po	Jo
VIII. Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi				
Treguesi : 7.1.1	0	Pjesërisht	Jo	Pjesërisht
Treguesi : 10.1.2	Të dhëna të pa qasshme	Jo	Po	0

Treguesi : 10.1.1	Jo	Jo	0	0
IX. Arsimi para-universitar				
Treguesi : 17.3.5	Të dhëna të pa qasshme	Jo	Po	0
X. Kujdesi shëndetësor primar				
Treguesi : 18.1.1	Të dhëna të pa qasshme	Të dhëna të pa qasshme	Të dhëna të pa qasshme	0
Treguesi : 18.2.1	Të dhëna të pa qasshme	Të dhëna të pa qasshme	Të dhëna të pa qasshme	Jo

Në Komunën e Obiliqit, nga 28 treguesit e performancës komunale gjashtë prej tyre nuk janë raportuar siç duhet, duke përbërë 18% të totalit, tre prej treguesve ishin të dokumentuar në mënyrë të plotë, përderisa shtatë prej tyre ishin mbështetur pjesërisht, katër nuk ishin dokumentuar me dëshmitë e kërkuara dhe në shtatë tregues ZKA-ja nuk kishte qasje për të vlersuar nëse dëshmitë e bashkangjitura ishin ato që kërkoheshin sipas dokumentit kryesor.

Në Komunën Skenderaj, gjashtë nga 28 treguesit nuk janë raportuar siç i kërkon dokumenti kryesor i performancës komunale, që përbën 21% të totalit, duke treguar një nivel më të lartë të raportimit të duhur në krahasim me tre komunat e tjera, përderisa 17 tregues janë mbështetur me dëshmitë e duhura, katër treguesi ishin mbështetur pjesërisht dhe vetëm dy prej tyre nuk ishin të qasshëm.

Në Komunën e Gjilanit, nga 28 tregues 15 prej tyre nuk ishin raportuar ashtu siç kërkohet me dokumentin kryesor të performancës komunale, apo 53% e totalit, duke treguar një nivel dukshëm më të lartë të raportimit jo të duhur, përderisa pesë tregues i kishte mbështetur me dëshmitë e duhura, tre tregues kishte mbështetur pjesërisht dhe tre tregues nuk ishin të qasshëm.

Në Komunën e Graçanicës, tetë nga 28 treguesit e performancës komunale nuk janë raportuar siç e kërkon dokumentit kryesor, që përbën 25% të totalit, nivel po ashtu i ulët i dokumentimit të duhur, përderisa pesë tregues ishin mbështetur ashtu siç e kërkon dokumenti kryesor, tetë tregues komuna i kishte dokumentuar pjesërisht ndërsa shtatë prej tyre nuk i kishte dokumentuar fare, dhe një tregues nuk ishte i qasshëm.

Shkaktarë të kësaj gjendje janë fillimisht raportimi për herë të parë përmes sistemit të performancës komunale, mungesa e kontrolleve brenda komunës e pastaj mungesa e kontrolleve edhe nga MAPL-ja si monitoruese e procesit gjatë raportimit të performancës komunale. Mungesa e kontrolleve të brendshme ka ndikuar në rezultatin e pikëve të fituara për GPK të komunave dhe kjo zbehë besueshmërinë ndaj funksionimit dhe qëllimit të këtij sistemi.

3.2.1 A ka vlerësuar MAPL si duhet treguesit e raportuar nga komunat?

MAPL-ja në performancën komunale të vitit 2020 i ka vlerësuar 38 komunat, ndërsa 14 prej tyre kanë qenë përfituese të GPK-së, tetë prej të cilave janë financuar nga Ministria. Ky proces i vlerësimit kryhet nga komisioni i cili emërohet me vendim nga Sekretari i Përgjithshëm.


Pas vlerësimit të performancës komunale, MAPL-ja njofton komunat për rezultatet individuale të tyre. Fushat e performancës komunale të cilat ne i kemi audituar janë vlerësuar në këtë formë nga MAPL në Tabelën 2:

Tabela numër 2 paraqet vlerësimin e performancës komunale për shtatë fushat e audituara

Raportet individuale				
Fushat	Obiliq	Skenderaj	Gjilan	Graçanicë
Transparenca Komunale	75.1	90.04	77.16	64.84
Planifikimi Hapësinorë	50	92.03	51.64	39.57
Infrastruktura Rrugore	72.69	66.91	63.41	27.9
Parkingjet Publike	45.64	72.32	43.02	26.32
Uji i Pijshëm	96.59	90.44	89.82	27.22
Kujdesi Primarë Shëndetësor	65.66	56.21	52.88	0
Zhvillimi Ekonomik Lokal	71.12	58.33	58.76	38.33

Detajet për komunat e audituara paraqiten në tabelat e më poshtme, ku është përfshirë se si është bërë vlerësimi dhe 12oentomi nga MAPL-së për secilin tregues të performancës komunale, vlerësimi dhe 12oentomi i bërë nga komunat përkatëse për këta tregues dhe vlerësimi i bërë nga ZKA. Aty ku ZKA ka konkluduar se dëshmitë për tregues janë jo relevante, këta tregues janë prezantuar me zero, ndërsa në dokumentet ku ne nuk kishim qasje ishte e pamundur të bëhet vlerësimi.


Grafiku 1 Komuna e Obiliqit



Grafiku më lartë paraqet ndryshimet në vlerësimin e treguesve në mes MAPL-së e cila paraqitet me ngjyrë portokalli e errët ndërsa vetëvlerësimi nga komunat me ngjyrë portokalli të hapur. Po ashtu, siç shihet në grafik zero në këta tregues është vlerësimi nga ZKA-ja. Arsyeja pse ZKA-ja ka vlerësuar me zero është se në këta tregues nuk janë mbështetur me dëshminë e kërkuar sipas dokumentit kryesor. Ky vlerësim në mënyre automatike pastaj ndikon në rezultatet e GPK-së.


Grafiket e detajuar gjenden në shtojcën IV.

Grafiku 2 Komuna Gjilanit




Grafiku më lartë paraqet ndryshimet në vlerësimin e treguesve në mes MAPL-së e cila paraqitet me ngjyrë portokalli e errët, vetëvlerësimi nga komunat me ngjyrë portokalli të hapur. Po ashtu, siç shihet në grafik zero në këta tregues është vlerësimi nga ZKA-ja. Zero tregon se nuk është bashkangjitur dëshmia e duhur. Grafiket e detajuar gjenden në shtojcën IV.

Grafiku 3 Komuna e Skenderajt



Grafiku më lartë paraqet ndryshimet në vlerësimin e treguesve në mes MAPL-së e cila paraqitet me ngjyrë portokalli të errët, vetëvlerësimi nga komunat me ngjyrë portokalli të hapur. Po ashtu, siç shihet në grafik zero në këta tregues është vlerësimi nga ZKA-ja. Grafiku i detajuar gjenden në shtojcën IV.

Grafiku 4 Komuna e Graçanicës



Grafiku më lartë paraqet ndryshimin në vlerësimin e treguesve në mes MAPL-së e cila paraqitet me ngjyrë portokalli të errët, vetëvlerësimi nga komunat me ngjyrë portokalli të hapur. Po ashtu, siç shihet në grafik zero në këta tregues është vlerësimi nga ZKA-ja. Grafiket e detajuar gjenden në shtojcën IV.

3.2.2 Vlerësimi i treguesve nga MAPL-ja për Grantin e Performancës Komunale

Me shpalljen e rezultateve për matjen e performancës komunale, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së emëron komisionin për matjen e Grantit të Performancës Komunale.


Katër kriteret minimale që komunat duhet të plotësojnë në mënyrë që të kualifikohen për Grantin e Performancës Komunale janë:

- Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar në nenin 13 të Rregullores së SMPK/GPK ;
- Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për të rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyrës;
- Opinioni i auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes; dhe
- Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale.

Komuna e Skenderajt e cila kishte rezultat të mirë në vlerësimin e performancës komunale nuk kishte arritur që të fitoj mjete nga GPK, për faktin se nuk kishte plotësuar një nga kushtet minimale, për t'u kualifikuar si përfituese e grantit (shpenzimin e 75% të buxhetit për investime kapitale). Megjithatë, auditimi ynë ka vënë në pah se edhe Komuna e Skenderajt nuk kishte dokumentuar të gjithë treguesit e performancës me dëshmitë relevante, siç është prezantuar në tabelën 1 dhe grafikun 3 të këtij raporti.

Komuna e Skenderajt ishte ankuar dhe kishte kërkuar nga MAPL që të merrej parasysh vlerësimi i tyre në vendin e parë të performancës komunale dhe të arsyetohej fakti i mos shpenzimit të buxhetit në investime kapitale pasi që viti 2020 ishte vit pandemik.


Rezultatet e MAPL-së dhe ZKA-së janë paraqitur në grafikët në vijim lidhur me dallimet në vlerësim në tri fushat e vlerësimit të GPK-së.

Grafiku 6. Qeverisja Demokratike

Në grafikun 6 janë paraqitur dallimet në vlerësimin e GPK-së në mes MAPL-së dhe ZKA-së.


Siç shihet në grafik tek fusha “Qeverisja Demokratike” dallimet në vlerësim të GPK-së, mes MAPL-së dhe ZKA-së janë domethënëse në komunitat e Gjilanit dhe Obiliqit. Dallimet në vlerësim mes ZKA-së dhe MAPL-së në Komunitat Graçanicë dhe Skenderaj janë më të vogla.

Ky ndryshim i madh mes vlerësimit të ZKA-së dhe MAPL-së në GPK vjen si rezultat që komisioni i vlerësimit të GPK-së e merr të mirëqenë vlerësimin e performancës komunale. Pasaktësia e vlerësimit të performancës komunale ka ndikuar edhe në rezultat të GPK-së.

Grafiku 7. Menaxhim Komunal

Në grafikun 7 janë paraqitur dallimet në vlerësimin e GPK-së në mes MAPL-së dhe ZKA-së.

Siç shihet në grafik tek fusha “Menaxhim Komunal” dallimet në vlerësim të GPK-së në mes MAPL-së dhe ZKA-së janë domethënëse në komunitat Gjilan dhe Obiliq.

Grafiku 8. Ofrim i Shërbimeve

Në grafikun 8 janë paraqitur dallimet në vlerësimin e GPK-së në mes MAPL-së dhe ZKA-së.

Siç shihet në grafik tek fusha “Ofrim i Shërbimeve Komunale” dallimet domethënëse në vlerësimin e GPK-së janë në komunat Gjilan, Graçanicë dhe Obiliq. Kjo ka ndodh për faktin se nga nëntë treguesit e vlerësuar në këtë fushë ZKA në Komunën e Gjilanit në tre prej tyre nuk kishte qasje në dokumentacion që e mbështet treguesin, në Komunën e Obiliqit qasje nuk kishte në gjashtë prej treguesve, dokumentet e të cilave ndodheshin të publikuara në faqen elektronike të komunës në kohën e vlerësimit nga MAPL-ja.

Mungesa e dokumenteve në faqen elektronike të komunave vjen si rezultat i kalimit të mirëmbajtjes nga Operatori Ekonomik tek Agjencia Shtetërore e Informacionit.

Vlerësimi ynë në katër komuna lidhur me 28 tregues ka nxjerr rezultate të ndryshme me vlerësimet nga MAPL-ja. Kjo ka ndodhur për shkak se ne nuk kishim qasje në 15 nga 28 treguesit. Për më tepër, në disa tregues vlerësimi ynë nuk korrespondon me atë të Ministrisë (detajet e vlerësimit i kemi bashkëngjitur në shtojcën III).

Si pasojë, vlerësimet e fushave dhe treguesve të njëjtë na japin rezultate të ndryshme.

3.2.3 Gjendja faktike e treguesve në terren

Procesi i verifikimit dhe dokumentimit të treguesve duhet të shpalojë raportimin dhe dokumentimin e duhur të komunave për treguesit e raportuar në terren. Ky proces duhet të dëshmojë nëse MAPL-ja kishte bërë vlerësimin e treguesve të performancës komunale si duhet.

MAPL nuk e kishte praktikuar verifikimin e treguesve përmes inspektimit fizik në terren deri në vitin 2020. Pavarësisht kësaj, as në vitin 2020, ky verifikim nuk ishte në kuadër të procesit të rregullt të vlerësimit mirëpo ishte kërkesë e Sekretari të Përgjithshëm që procesi i vlerësimit të pezullohet dhe të bëhet verifikimi në terren.

Sekretari i Përgjithshëm ka pezulluar procesin e vlerësimit të performancës komunale para shpalljes së rezultateve dhe ka kërkuar që të bëhej verifikim fizik i treguesve në terren. Edhe pse ky verifikim kishte gjetur ndryshime mes gjendjes në terren dhe treguesve të raportuar, një gjë e tillë nuk ka ndikuar në radhitjen e komunave përfituese. Megjithatë duhet thënë se raporti nga Komisioni ad-hoc nuk jep informacione të mjaftueshme për gjendjen e treguesve në terren meqë në të nuk specifikohen adresat e treguesve të verifikuar dhe nuk ofron informacione nëse është bërë krahasim i gjendjes në terren me gjendjen e raportuar. Për më shumë, një raport i tillë është dokument në format të Microsoft Word që nuk është i protokolluar dhe vulosur, gjë që nuk jep siguri se një raport i tillë nuk është ndryshuar apo se nuk mund të ndryshohet.

MAPL, përkitazi me verifikimin e treguesve në terren gjatë vlerësimit të performancës komunale, është arsyetuar se nuk ka kërkesë ligjore për të kryer edhe verifikimin fizik. Nga gjashtë¹⁰ grupe të treguesve të performancës komunale, vetëm grupi i gjashtë ka për bazë dëshmitë të cilat duhet të verifikohen edhe në terren.

Pavarësisht arsytimit të MAPL-së, që nuk kishte bazë ligjore për verifikim fizik në terren, e njëjta kishte dy dokumente të brendshme, që duhej t'i referohej për vlerësimin e performancës komunale, si:

- Rregulloren Nr. 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Granitit për Performancë Komunale, dhe
- Dokumentin Kryesor të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale.

Të dyja këto dokumente përcaktojnë verifikimin fizik në terren, megjithatë MAPL kishte anashkaluar një hap të tillë. Rregullorja përcakton që verifikimi fizik bëhet pas raportimit të komunave. Gjithashtu, rregullorja në fjalë përcakton se një formë tjetër shtesë e verifikimit mund të aplikohet në pajtim me dokumentin e metodologjisë së verifikimit, i cili hartohet nga MAPL, si pjesë e Dokumentit Kryesor.

Dokumenti Kryesor përcakton që Ministria duhet të aplikoj dy lloje të verifikimit të të dhënave të raportuara nga komunat, verifikimin e rregullt dhe ex-post. Verifikimi i të dhënave bëhet në dy faza:

- 1) Faza e parë – nënkupton verifikimin paraprak, pas pranimit të raporteve të komunave nga Divizioni për Performancë, i cili bëhet në proces të sistemimit të të dhënave në data bazë, dhe
- 2) Faza e dytë – nënkupton verifikimin sipas mostrës, që ndodh pas hartimit të raportit të përgjithshëm për performancë.

¹⁰ **Grupi 1** - Treguesit që vijnë nga intraneti dhe platformat elektronike për raportim, verifikimi është drejtpërdrejtë duke ju referuar vlerave

Grupi 2 - Treguesit që kanë për bazë dëshmi në raporte dhe dokumente të cilat janë edhe në MAPL, verifikohen duke iu referuar raporteve të ndryshme;

Grupi 3 - Treguesit që kanë për bazë dëshmi në raporte dhe dokumente nëpër institucione të tjera të Kosovës (ZKA, Ministri të linjave përkatëse) verifikohen duke iu referuar raporteve të ndryshme;

Grupi 4 - Treguesit që kanë për bazë dëshmi prej ueb faqeve të komunave;

Grupi 5 - Treguesit që kanë për bazë dëshmi prej dokumenteve të ndryshme të komunës;

Grupi 6 - Treguesit që kanë për bazë dëshmi për të cilat është e domosdoshme vizita në terren.

Komisioni ad-hoc për verifikim në terren në dhjetor të vitit 2021 kishte realizuar vizitat në dhjetë¹¹ komuna.

Pesë treguesit e verifikuar nga Komisioni ad-hoc në komuna, janë:

9.2.4 Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave;

10.1.3 Vendndalimet e shënuara për automjetet e transportit publik-autobus;

11.1.3 Vend parkimet e destinuar për taksit;

11.1.4 Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna E-kioska; dhe

17.1.3 Shkollat e pajisura me kabinet të TIK-ut.

MAPL kishte verifikuar pesë treguesit në dhjetë komuna, ku dy nga to (Obiliqi dhe Skenderaj) janë komuna të përfshira në këtë auditim.

Në raportin e hartuar nga Komisioni ad-hoc, nga pesë treguesit e përzgjedhur, vetëm treguesit: "11.1.4 E-kiosku" dhe "17.1.3 shkollat e pajisura me kabinet për teknologji informative" kanë qenë të identifikueshme se në cilat komuna janë kryer, ndërsa tre treguesit e tjerë nuk mund të identifikohen se në cilat adresa janë, pasi që në raport janë paraqitur me foto dhe si të tilla nuk kanë adresë dhe është e vështirë të identifikohet në cilën lagje apo fshat janë verifikuar treguesit në fjalë.

Ky komision, gjatë verifikimit të treguesve në terren, nuk i ka përdorur "Formularët për vizitën në terren", të cilët janë pjesë e Dokumentit Kryesor, që konsiderohet dokument referues që duhet të merret parasysh gjatë verifikimit fizik në terren. Në vend të tyre kishin hartuar një raport me foto dhe sqarime të pakta, i cili nuk jep detaje të mjaftueshme për saktësinë e të dhënave të raportuara nga komunat.

Kjo kishte ndodh si rezultat i mungesës së informacioneve nga ana e komisionit lidhur me përdorimin e formularëve për vizitë në terren. Për pasojë, hartimi i raportit në Microsoft Word i pa protokolluar dhe nënshkruar nga MAPL-ja nuk jep siguri të arsyeshme për mos ndërhyrje të vazhdueshme në të, e po ashtu edhe për kohën dhe saktësinë e raportimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë vizitës në terren ka verifikuar dy nga treguesit që kishte verifikuar komisioni ad-hoc i MAPL:

-Infrastruktura rrugore-treguesi 9.2.4 Kilometra Rrugë në zonën urbane me shteg të biçikletave; dhe

-Parkingjet publike - treguesi 11.1.3 vend parkimet e destinuar për taksit.

Këta dy tregues janë verifikuar në terren nga komisioni ad-hoc i Ministrisë, gjithashtu edhe nga ZKA-ja. Ndërsa tre treguesit në vijim janë verifikuar vetëm nga ZKA-ja:

-Infrastruktura rrugore - treguesi 9.1.1 Rrugë të reja të asfaltuara për herë të parë gjatë vitit;

-Infrastruktura rrugore - treguesi 9.2.2 Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik; dhe

-Parkingjet publike - 11.1.1 Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunën përkatëse.

11 Skenderaj, Rahovec, Junik, Gjakovë, Drenas, Lipjan, Obiliq, Han i Elezit, Kaçanik dhe Mitrovicë e Jugut.

Në katër komunat e vizituara për pesë tregues, në terren kemi vërejtur që në të gjitha këto raste komunat nuk i kishin bashkëngjitur dëshmitë e njëjta për treguesit e njëjtë.

Sipas dokumentit kryesor, punët e përfunduara dhe të raportuara në formularë duhet të dokumentohen me kontratë, faturë dhe pranimin teknik të punëve. Këto dokumente kërkohen në fushat e verifikuara në terren si: rrugë të reja, ndriçimi publik, shteg të biçikletave dhe parkingje publike.

Gjendja në terren, kryesisht shfaqet të jetë më mirë se sa është raportuar mirëpo treguesit nuk janë mbështetur me dokumentet relevante. Komunat e verifikuara nuk kishin bashkëngjitur dokumentet e duhura për tregues të caktuar.

Më poshtë është paraqitur në detaje gjendja në komunat e audituara pas ekzaminimit fizik¹²:

Komuna e Obiliqit

Treguesi *“numri i vend parkimeve formale të destinuara vetëm për taksi”*- Komisioni ad-hoc kishte raportuar që ishte në rregull me shënjimet për taksi. Të njëjtën gjendje e kemi konstatuar edhe ne.

Verifikimi ynë për treguesin e *“Kilometra rrugë të shtruara për herë të parë gjatë vitit ”* nga 20.58 km sa kishte raportuar Komuna e Obiliqit kemi verifikuar një mostër që përbën rreth 40% të rrugëve të reja të shtruara, të raportuara në vitin 2020. Mirëpo për të gjitha këto komuna i kishte referuar në raportin vjetor të kryetarit të komunës në vend se të referoj te kontrata, fatura dhe raporti i pranimit teknik.

Për treguesin *“Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunën përkatëse”*- Komuna e Obiliqit kishte raportuar 39 zona për parkingje publike për vitin 2020 . Gjendja aktuale ndryshon vetëm tek parkingu në qendër të Obiliqit pasi që komuna zonën e raportuar në qytet për parking tanimë e ka zëvendësuar me shesh, ndërsa parkingu është zhvendosur në zonë të re të qytetit. Gjendja e raportuar në vitin 2020 nuk mund të verifikohet siç ishte raportuar për shkak të ndryshimeve në qytet. Nëse do të shfrytëzohej Sistemi Informativ Gjeografik (GIS) një ndryshim i tillë do të ishte lehtë i verifikueshëm sepse GIS mundëson regjistrimin e ndryshimeve në infrastrukturë.

Për treguesin *“Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik”*, Komuna e Obiliqit kishte raportuar 113.3 km rrugë të pajisura me ndriçim publik në vitin 2020. Këto punë të përfunduara në vitin 2020 komuna kishte referuar si dokument mbështes raportin vjetor të punës së kryetarit në vend se t'i referohej kontratës, faturës dhe pranimin teknik. Këto dokumente komuna na i ka ofruar pas vizitës sonë në terren.

Komuna e Skenderajt

Për treguesin *“Kilometra Rrugë në zonën urbane me shteg të biçikletave”* Komuna e Skenderajt kishte raportuar 2.2 km prej të cilave 0.9 km në vitin 2020. Si dëshmi komuna kishte referuar faqen elektronike të komunës në vend se t'i referohej dokumenteve zyrtare si kontratës, faturës dhe pranimin teknik.

¹² Ekzaminimi fizik është kryer gjatë muajit korrik nga ekipi auditues i ZKA-së 2023

Komisioni ad-hoc nga MAPL kishte raportuar gjendjen në terren se në komunë ekziston shtegu prej tre mijë metrave për biçikleta. Gjatë ekzaminimit tonë në terren, ne kemi vërejtur se kishte shteg të biçikletave, megjithatë komuna nuk na ka ofruar dëshminë e pranimit teknik që këto punë kanë përfunduar në vitin 2020.

Për treguesin *“Numri i vend parkimeve formale të destinuara vetëm për taksi”*, komuna kishte raportuar gjithsej 17 vend parkime për taksi. Në raportin e komisionit ad-hoc nuk kishte të dhëna të qarta mbi numrin e vend parkimeve për taksi. Ne kemi verifikuar dy lokacione të ndryshme brenda qytetit që ishin të dedikuara për vend parkim të taksive.

Për treguesin *“Kilometra rrugë të shtruara për herë të parë gjatë vitit”* Komuna e Skenderajt kishte raportuar gjithsej 26.111 metra rrugë të shtruara. Ne kemi arritur të verifikojmë 8,000 metra apo 30% të rrugëve të reja të asfaltuara. Dëshmisë të cilës iu kishte referuar është vetëm informuese sepse përmban të gjitha rrugët dhe emërtimet e kontratave përkatëse mirëpo nuk e përmban edhe vet kontratën, faturën dhe pranimin teknik, siç kërkohet. Pas vizitës në terren komuna na e ka siguruar dëshminë e pranimit teknik në të cilin megjithatë nuk specifikohet gjatësia e rrugës.

Për treguesin *“Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunën përkatëse”* Komuna e Skenderajt ka raportuar 28 zona për parkingje publike apo 1,315 vend parkingje për automjete motorike. Ne kemi arritur të verifikojmë 13 zona parkingje publike. Të gjitha këto kishin të përfshirë edhe shenjzimin e parkingut për persona me aftësi të kufizuara. Mirëpo, dëshmitë e ofruara nga komuna nuk dokumentojnë që punët e raportuara ishin të përfunduara gjatë vitit 2020.

Për treguesin *“Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik”*, komuna kishte raportuar 86.98 km rrugë të pajisura me ndriçim publik. Një pjesë e projektit për ndriçim ishte shtrirë në fshatrat e Komunës së Skenderajt dhe pjesa tjetër në sheshin kryesor të qytetit. Në këtë tregues komuna e ka bashkëngjitur dëshminë, mirëpo nuk ka ofruar dëshmi të pranimit teknik për punët e përfunduara.

Komuna e Gjilanit

Komisioni ad-hoc i MAPL-së nuk kishte përfshirë në mostër verifikimin fizik në Komunën e Gjilanit. Verifikimi fizik për këta tregues është kryer vetëm nga ekipi i auditimit.

Për treguesin *“Kilometra Rrugë në zonën urbane me shteg të biçikletave”* komuna kishte raportuar 6.6 km. Këtë tregues e kishte mbështetur me tri kontrata të vitit 2020. Megjithatë kontratat e bashkëngjitura nuk përmbajnë detaje të mjaftueshme lidhur me gjatësinë e rrugëve. Gjatë verifikimit fizik kemi verifikuar komplet shtegun dhe ishte siç ishte raportuar.

Për treguesin *“Numri i vend parkimeve formale të destinuara për taksi”*, komuna ka raportuar 115 vend parkime për taksi. Ne kemi verifikuar dy parkingje të taksive (zona tek stacioni i autobusëve dhe zona tek parku i qytetit) dhe ishte siç ishte raportuar.

Për treguesin *“Kilometra rrugë të shtruara për herë të parë gjatë vitit”* në Komunën e Gjilanit nga gjithsej 10.11 km të raportuara, ne kemi verifikuar 4.16 km apo rreth 40% të rrugëve të reja të asfaltuara në territorin e komunës. Dokumenti i bashkëngjitur si dëshmi nuk ka qenë relevant sepse dokumenti i bashkëngjitur ishte njoftimi për nënshkrimin e kontratës dhe si i tillë është i pamjaftueshëm si dëshmi.

Për treguesin “*Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunën përkatëse*”, Komuna e Gjilanit ka raportuar 18 parkingje publike apo 1,191 vend parkime për automjetet motorike. Për këtë tregues, ne kemi verifikuar shtatë lokacione, të gjitha këto kishin të përfshira edhe shenjëzimin për parkingun e personave me aftësi të kufizuara. Komuna, për këtë tregues nuk e ka bashkëngjitur dëshminë relevante që kërkohet, pra, kontratat koncesionale të komunës me partnerë privat dhe raporteve monitoruese të parkingjeve publike.

Për treguesin “*Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik*”, komuna ka raportuar 215.29 km ndriçim publik ku një pjesë ishte shtrirë në fshatrat e Komunës së Gjilanit dhe pjesa tjetër (më e madhe) ishte shtrirë në drejtimin e rrugës kryesore që lidh qytetin e Gjilanit me atë të Ferizajt deri tek stacioni i autobusëve¹³. Në këtë tregues komuna si dëshmi ka bashkëngjitur njoftimin për kontratë i cili nuk është dëshmi relevante.

Komuna e Graçanicës

Komisioni ad-hoc i Ministrisë nuk kishte përfshirë në mostër verifikimit fizik në Komunën e Graçanicës.

Për treguesin “*Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave*” Komuna e Graçanicës e kishte raportuar me zero pasi që nuk ka shteg për biçikleta.

Për Treguesin “*Kilometra rrugë të shtruara për herë të parë gjatë vitit*” Komuna kishte raportuar 3.3 km. Në teren janë vizituar gjithsej 1.678 km rrugë të shtruara sipas kontratave të nënshkruara. Komuna kishte bashkëngjitur dokumentin përmbledhës të përgatitur nga drejtoria e urbanizimit në vend që të referoj kontratën, faturën dhe pranimin teknik.

Për treguesin 11. *Parkingjet publike – treguesi 11.1.3 vend parkimet e destinuar për taks*i, kemi vizituar dy vendndalimet të transportit publik - taks, i, e që përfshinë rreth 15 vend parkime për taks dhe paraqet gjithsej numrin e vend parkimeve në komunë. Komuna kishte bashkëngjitur dokumentin përmbledhës nga drejtoria e infrastrukturës.

Për treguesin “*Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik*”, komuna ka raportuar 92.67 km rrugë të ndriçuara që përfshinë gjithë hapësirën publike të ndriçuar në komunë. Sa i përket vitit 2020, sipas koordinatorit të performancës komunale, nuk ka pasur kontratë tjetër.

Në treguesin “*Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunën përkatëse*”, komuna ka raportuar dy vend parkingje publike që i kemi vizituar në terren dhe asnjëra nga këto nuk i takonin vitit 2020, sipas koordinatorit të performancës komunale nuk ka pas vend parkingje të reja të ndërtuara në vitin 2020.

Gjendja e paqartë lidhur me raportimin dhe dokumentimin në këtë fushë vjen si rezultat që komunitat e audituara kanë ndjekur praktikën e veta në raportimin dhe dokumentimin e këtyre fushave dhe jo siç kërkohet në dokumentin kryesor. Ky mos dokumentim ka ndikuar që komunitat të mos e paraqesin gjendjen faktike ashtu siç qëndron në terren.

¹³ (foto nga gjeoportali)

4. Konkluzionet

Sistemi i menaxhimit të performancës komunale aktualisht nuk është duke funksionuar si duhet. Procesit të dokumentimit i mungojnë dëshmitë mbështetëse thelbësore, gjë që çon në vlerësimin e performancës komunale bazuar në të dhëna jo të plota dhe të pasakta. Ky vlerësim jo i duhur jo vetëm që ndikon në vlerësimin e përgjithshëm të performancës së komunës por gjithashtu ka pasoja në vlerësimin e Grantit të Performancës Komunale. Rrjedhimisht, procesi i vlerësimit i përcjellur me mangësitë e përmendura, ka ndikuar që renditja e komunave përfituese të mos jetë e saktë. Adresimi i këtyre çështjeve është thelbësor për të siguruar vlerësimin e saktë dhe të drejtë të performancës komunale dhe GPK-së.

Treguesit e raportuar nuk janë dokumentuar ashtu siç kërkohet me Dokumentin Kryesor të performancës komunale, kjo pasi që komunat e audituara kishin ndjekur praktikën e veta të raportimit. Mungesa e kontrolleve nga vet komunat dhe MAPL-ja i kishte lënë këto të fundit në rehatinë e raportimit sipas njohurive të tyre e jo sipas kërkesave të raportimit. Për secilën fushë komunat aplikojnë mënyra të ndryshme të dokumentimit. Në një rast kemi gjetur për dëshmi njoftimin për kontratë, në rastin tjetër raportin vjetor të punës së kryetarit të komunës, pastaj dokumente të bashkangjitura të pa vulosura dhe pa protokolluara, dhe rasti tjetër vetëm numri i protokollit të dokumentit pa dokumentin e bashkangjitur. Këto ishin praktikën e përdorura nga komunat e audituara e që nuk korrespondojnë me kërkesat e dokumentit kryesor për raportim të performancës komunale.

Gjendja reale e treguesve në terren në komunat e audituara paraqitet të jetë shumë më mirë se sa dokumentimi që i bëhet nga komunat, kjo për faktin që komunat nuk kishin arritur të bashkëngjisnin dokumentet burimore të cilat dëshmojnë punët e përfunduara në terren. Në mungesë të dëshmisë për gjatësinë e rrugës që nuk ka njësi matëse koherente në komunat e audituara, disa raportojnë me metër e disa me kilometër, shtrirjen e ndriçimit publik që raportohet në akumulativ dhe jo vetëm në vitin raportues, e që kjo ka ndikuar që komunat të ndjekin praktikën e tyre të raportimit dhe mos të arrijnë të pasqyrojnë gjendjen reale nga terreni. Kjo paqartësi në dokumentim vjen si pasojë e mungesës së njohurive nga zyrtarët lidhur me kërkesat për raportim. Një faktor tjetër me rëndësi në dokumentimin e raportimit të treguesve nga terreni është mungesa e përdorimit të Sistemit të Informacionit Gjeografik i (GIS) nga komunat.

Treguesit e raportuar nga komunat në vlerësimin e performancës komunale nuk ishin vlerësuar si duhet nga MAPL-ja. Kjo ka ndikuar pastaj edhe në vlerësimin jo të saktë të GPK-së e cila si pasojë rangon komunat më lartë se sa që është gjendja reale e performancës vjetore të tyre.

MAPL-ja nuk kishte ndjekur praktikën e vlerësimit të treguesve në terren deri në vitin 2020. Edhe pse këtë vit MAPL kishte kryer një proces formal të vlerësimit të treguesve në terren, kjo gjë ishte bërë pas kohës së rregullt të vlerësimit të performancës komunale, pra ishte bërë me vonesë e rrjedhimisht një veprim i tillë nuk kishte ndikim në rezultatet e GPK-së. Ky aktivitet i ndërmarrë përveç që nuk i kishte shtuar vlerë procesit, përkundrazi vetëm e kishte pezulluar atë deri sa është kryer formaliteti në terren.

5. Rekomandimet

Rekomandimet për Komunitet:

- Komunitet duhet të sigurohen që mos të ketë ndryshime të shpeshta të zyrtarëve të përfshirë në procesin e deklarimit të performancës komunale; dhe
- Për të ruajtur dëshmi për të dhënat e raportuara në të kaluarën dhe për ato të reja, sidomos në fushën e infrastrukturës, komunitet duhet të fillojnë të përdorin Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS).

Rekomandimet për MAPL-në:

- MAPL-ja dhe komunitet duhet t'u mundësojnë koordinatorëve dhe zyrtarëve përgjegjës për performancë komunale që në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë profesionale lidhur me deklarimin e performancës komunale dhe përdorimin e Sistemit për Menaxhim të Performancës Komunale nëpërmjet trajnimeve;
- MAPL-ja duhet të bëjë azhurnimin e Dokumentit Kryesor në mënyrë që t'i harmonizoj kërkesat e dokumentit me kërkesat e treguesve dhe t'i qartësojë treguesit që raportohen në akumulativ dhe njësitë matëse të tyre;
- MAPL-ja duhet të rris nivelin e kontrolleve gjatë kohës së raportimit të komunave dhe të vlerësojë performancën komunale me mostër dhe jo 19 fushat me 119 tregues;
- MAPL-ja duhet të sigurojë të bëhet vlerësimi i saktë i performancës komunale, saktësi kjo që ndikon direkt edhe në vlerësimin e Grantit të Performancës Komunale; dhe
- MAPL duhet të sigurojë se janë kryer vizita në terren për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara. Vizitat të bëhen me kohë në mënyrë që të parandalohen pasaktësi në raportim apo edhe rangim i mundshëm i gabuar i komunave.

Shtojca I

Kriteret e auditimit

Matja e performancës bëhet me qëllim të sigurimit të monitorimit të ofrimit të shërbimeve përmes matjeve të vlefshme (vlerësim i organizuar sistematik), ofrimit të informatave për të përmirësuar vendimmarrjen në komunë, për të motivuar autoritetet e qeverisjes lokale, si dhe për të promovuar përgjegjësinë dhe llogaridhënien e autoriteteve komunale në raport me qytetarët, duke ngritur kështu transparencën dhe krahasueshmërinë.

- Komunat duhet të përdorin dokumentacionin standard për regjistrimin dhe raportimin e treguesve sipas Dokumentit Kryesor për Raportimin e Performancës Komunale, ku për secilin tregues është i specifikuar se cilat dokumente duhet të bashkëngjiten si burim i të dhënave (kriteret specifike për shtatë fushat dhe 28 treguesit janë referencuar nga Dokumenti Kryesor për Performancë Komunale, të detajuara gjenden në Memon parastudimore);
- Komunat duhet raportuar treguesit në përputhje me Dokumentin Kryesor për Raportimin e Performancës Komunale, dhe gjendjen e verifikimit fizik nga terreni për treguesit që përfshinë projektet kapitale të realizuara në zona të ndryshme nëpër komuna;
- Ministria është përgjegjëse për menaxhimin e SMPK, siguron funksionimin e SMPK-së duke përfshirë procedurën e mbledhjes, përpunimit, verifikimit dhe raportimit të të dhënave, periudhën e raportimit dhe linjat e llogaridhënjes gjatë procesit të raportimit dhe sigurimit të cilësisë së të dhënave; (neni 6 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 (2.4)

Ministria është përgjegjëse për përpunimin, analizimin, verifikimin e të dhënave të raportuara nga komunat dhe harton raportin e performancës komunale (te shtohet referenca ku shënon verifikimi ne terren)neni 14 paragrafi 3.

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi përfshin vlerësimin e performancës komunale të vitit 2020 vlerësimi i të cilit është bërë në pranverën e vitit 2021 dhe mjetet i janë ndarë komunave në vitin 2022.

Komunat përfituese për vitin 2020 Fushëveprimi i këtij auditimi përfshin vlerësimin e performancës komunale të vitit 2020, vlerësimi i të cilit është bërë në pranverën e vitit 2021 dhe mjetet i janë ndarë komunave në vitin 2022.

14 nga 38 komunat e vlerësuara i kanë përmbushur të katër kushtet minimale dhe janë kualifikuar për grant të performancës komunale për vitin 2022. Kjo do të thotë që 36.84% e komunave në Kosovë ishin komuna përfituese të grantit të performancës komunale në vitin 2022

Komunat përfituese për vitin 2020 nga MAPL janë paraqitur në tabelë:

Komunat e financuar nga GPK për vitin 2022	Shuma e Grantit të ndarë në Euro (€)
1. Gjilan	864,306.35
2. Obiliq	808,140.75
3. Pejë	761,186.71
4. Kaçanik	306,057.29
5. Han i Elezit	82,554.64
6. Graçanicë	81,660.91
7. Mitrovicë e Jugut	61,367.39
8. Shtërpçë	34,725.96
	3,000,000.00

Fushëveprimi ynë për këtë auditim shtrihet në këto komuna: Gjilan, Obiliq dhe Graçanicë si përfituese të Grantit të Performancës Komunale (të hijezuara në tabelë), ndërsa dhe Komunën e Skenderajt, si komunë e cila ishte radhitur e para në vlerësimin e performancës komunale për vitin 2020 por nuk kishte arritur që të fitoj mjete nga GPK, për faktin se nuk kishte plotësuar një nga kushtet minimale, për t'u kualifikuar si përfituese e grantit (shpenzimin e 75% të buxhetit për investime kapitale).

Metodologjia e auditimit

Metodologjia për auditimin e grantit të performancës komunale është një proces i strukturuar i përdorur për të vlerësuar dhe monitoruar se si fondet publike janë përdorur nga një komunë për të arritur qëllimet e tyre të performancës. Kjo është një përgjegjësi e theksuar për organizatat e qeverisë lokale dhe agjencitë që ndihmojnë me financim të grantit të performancës.

Metodologjia për auditimin "Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020" është një proces i strukturuar i përdorur për të vlerësuar dhe monitoruar MAPL-në dhe komunat të cilat kanë raportuar performancën komunale.

Auditimi është kryer nëpërmes: mbajtjes së intervistave me të gjitha palët e përfshira në sistem, shqyrtimit të dokumenteve relevante që lidhen me procedurat e punës dhe rregulloret, raportimet eventuale, dokumentet sipas të cilave përcaktohen format e komunikimit me akterët e jashtëm, etj.

Për më shumë pyetjeve të auditimit ju kemi përgjigjur duke:

- Analizuar dhe krahasuar të dhënat me Dokumentin Kryesor të Performancës Komunale dhe Rregulloren 01/2020 për menaxhimin e sistemin e të performancës komunale;
- Vlerësuar komunikimin (qarkullimin e informatave) nga ofruesit e shërbimeve të ndryshme jashtë Komunës tek drejtoritë relevante komunale dhe nga to tek Zyrtarët Komunal. Për këtë, ne do të analizojmë formularët e plotësuar të SMPK-së për t'i krahasuar me burimin e të dhënave në të cilat janë mbështetur;
- Krahasimi mes të dhënave të raportuara nga komunat, vlerësimi nga MAPL-ja dhe dëshmime relevante që është dashur të mbështeten;
- Vizitat në terren për projektet kapitale të raportuara të përfunduara në vitin 2020;
- Vlerësimin e mënyrës se si Koordinatorët Komunal bëjnë verifikimin e të dhënave dhe nëse ato janë plotësuar përsëri pas vërejtjeve eventuale të dhëna; dhe
- Kryer intervista edhe me palët e dyta të interesit së bashku me zyrtarët komunal.

Problemi i auditimit


Nisur nga problemet e identifikuar nga raportet e vlerësimit të performancës komunale, si dhe gjetjet e raporteve të auditimit të mëparshëm të këtij procesi, ZKA-ja ka vendosur të ndërmarrë një auditim të ri. Kjo iniciativë vjen si rezultat i vazhdueshëm në ndikimin e përmirësimit të sistemeve përmes dhënies së rekomandimeve. Në këtë fushë ZKA ka bërë auditime të vazhdueshme, ku vetëm me DEMOS ka publikuar deri më tani katër raporte të auditimit. Në fokusin e raporteve të mëparshëm ishin procedurat e prokurimit dhe menaxhimi i kontratave ndërsa tani fokusi është vënë tek procesi i vlerësimit dhe dokumentimit të performancës komunale.

Rezultatet e parastudimit tregojnë se disa prej komunave kanë dorëzuar dokumentacion jo të plotë ose jo të saktë si prova për disa tregues të specifikuar të deklaruar të performancës komunale. Megjithatë, këto dokumentacione janë pranuar nga MAPL si të mjaftueshme, çka ua ka mundësuar komunave të përfitojnë nga Grantet e Performancës Komunale.

Nisur nga këto probleme të identifikuar ndër vite, mbi funksionimin e sistemit të SMPK-së dhe rëndësinë e tij si një mekanizëm për përmirësimin e qeverisjes lokale, ZKA ka vendosur të bëjë një auditim të tillë. Ky auditim synon të sigurojë një analizë transparente dhe të detajuar e cila do të vlerësojë çështjet kryesore dhe do të sugjerojë përmirësime të mundshme. Duke e vlerësuar rëndësinë e këtij sistemi, ky auditim ka për qëllim të forcojë besimin publik në procesin e vlerësimit komunal dhe të garantojë që fondet shpërblejnë ato komuna që vërtetë e meritojnë.

Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant

Komunat e fillojnë procesin e plotësimit të formularit për vitin e kaluar në vitin aktual dhe kohëzgjatja e raportimit është 45 ditë. Pas këtij afati kohor, qasja në sistem për ta lejohet vetëm për pamje/raportim. Akterët e përfshirë në deklarin e performancës komunale janë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si zhvilluese, monitoruese dhe vlerësuese e sistemi dhe komunat e Kosovës si deklarues të performancës komunale. Procesi është paraqitur në diagramin e më poshtëm:



Siç shihet në diagram, procesi i matjes së performancës fillon me njoftimin që MAPL-ja u dërgon komunave për deklarin e performancës komunale, komunat përgatiten përmes koordinatit dhe zyrtareve për performancë komunale për të raportuar për fushat që u kërkohet. Detajet e proces janë paraqitur në diagram.

Shtojca II Vlerësimi sipas MAPL-së dhe ZKA-së

Rezultati i performancës në fushën 1: Qeverisja Demokratike																			
Komuna	Roli I Kuvendit Komunal si Organ Mbikerqyres						Pjesëmarrja, konsultimi, dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve				3. Transparenca, qasja ne informata dhe integriteti						Gjithsej pikë	Rezultati në% MAPL	
	TP1	TP2	TP3	TP4	TP5	Tot II	TP6	TP7	TP8	Tot II	TP9	TP10	TP11	TP12	TP13	Tot III			Total
Gjilan	2	3	0	0	0	5	0	1	2	3	3	4	1	0	0	8	16	42.10526316	
Graçanicë	2	1	0	0	0	3	0	0	4	4	0	2	1	0	0	3	10	26.31578947	
Obiliq	2	3	0	2	1	8	0	1	4	5	0	4	2	0	0	6	19	50	
Skenderaj	2	3	2	2	2	11	2	4	4	10	2	2	1	0	2	7	28	73.68421053	

ZKA: Rezultati i performancës në fushën 1: Qeverisja Demokratike																			
Komuna	Roli I Kuvendit Komunal si Organ Mbikerqyres						Pjesëmarrja, konsultimi, dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve				3. Transparenca, qasja ne informata dhe integriteti						Gjithsej pikë	Rezultati në% ZKA	
	TP1	TP2	TP3	TP4	TP5	Tot II	TP6	TP7	TP8	Tot II	TP9	TP10	TP11	TP12	TP13	Tot III			Total
Gjilan	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		4	0	0	4	4	10.52631579	
Graçanicë	2	0	2	0	0	4	0	0	4	4		2	1	4	0	5	13	34.21052632	
Obiliq	0	1	0	0	0	0	0	0	4	4	0	2	2	0	0	2	6	15.78947368	
Skenderaj	2	0	3	2	0	7	4	4	4	12	2	2	1	4	2	9	28	73.68421053	

Rezultati i performancës në fushën 2: Menaxhimi komunal													
Komuna	IV				V			VI				Gjithsej pikë	Rezultati në % MPAL
	IP14	IP15	IP16	Tot IV	IP17	IP18	Tot V	IP19	IP20	IP21	Tot VI		
Gjilan	3	0	2	5	0	4	4	0	2	0	2	11	39.28571429
Graçanicë	3	1	1	5	0	0	0	0	2	0	2	7	25
Obiliq	0	1	2	3	3	4	7	0	5	1	6	16	57.14285714
Skenderaj	3	0	0	3	3	0	3	0	2	3	5	11	39.28571429

ZKA:Rezultati i performancës në fushën 2: Menaxhimi komunal													
Komuna	IV				V			VI				Gjithsej pikë	Rezultati % ZKA
	IP14	IP15	IP16	Tot IV	IP17	IP18	Tot V	IP19	IP20	IP21	Tot VI		
Gjilan	0	0	0	0	0	2	2	0	2	3	5	7	25
Graçanicë	3	1	1	5	3	0	3	0	0	0	0	8	28.57142857
Obiliq		1	2	3	3		3	0	0	3	3	9	32.14285714
Skenderaj	3	0	0	3	3	0	3	0	1	4	5	11	39.28571429

Rezultati i performancës në fushën 3. Ofrimi i shërbimeve

Komuna	VII			VIII				IX			X			Gjithsej pikë	Rezultati në % MAPL
	IP22	IP23	Tot VII	IP24	IP25	IP26	Tot VIII	IP27	IP28	Tot IX	IP29	IP30	Tot X		
Gjilan	4	2	6	3	2	5	0	2	1	5	19	5	6	17	65.38461538
Graçanicë	0	2	2	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	2	7.692307692
Obiliq	4	2	6	3	0	3	0	2	3	5	19	5	8	19	73.07692308
Skenderaj	4	2	6	3	0	6	0	2	1	0	15	0	1	7	26.92307692

ZKA: Rezultati i performancës në fushën 3. Ofrimi i shërbimeve

Komuna	VII			VIII				IX			X			Gjithsej pikë	Rezultati në % ZKA
	IP22	IP23	Tot VII	IP24	IP25	IP26	Tot VIII	IP27	IP28	Tot IX	IP29	IP30	Tot X		
Gjilan		2	2	0	3	0	3	0	2	2				7	26.92307692
Graçanicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Obiliq			0	0		0	0	0						0	15.38461538
Skenderaj	4	2	6	0	0	0	0	0	0	0				6	23.07692308

Shtojca III Tabela e poentimit të treguesve të GPK-së

#	Tema / Fusha e treguesit	# maks. i pikëve	Poentimi	Ref
I. QEVERISJA KOMUNALE - Roli i Kuvendit Komunal, Pjesëmarrja dhe Përfshirja e qytetarëve, Transparenca		40	Shuma e nëntemave	
I	Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	13	Shuma e treguesëve	
1	Dorëzimi me kohë dhe miratimi i Buxhetit Komunal në Kuvendin Komunal	2	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 100%. 	SMPK 3.2.1
2	Diskutimi për raportet tremujore buxhetore nga Kuvendi Komunal	3	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 74.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është 75% - 100%. 	SMPK 2.3.2
3	Diskutimi për raportin e performancës komunale nga Kuvendi Komunal për vitin e kaluar	2	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është më i vogël se 100%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 100%. 	SMPK 2.3.3
4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve si dhe diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi i brendshëm në Kuvendin Komunal	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është më i vogël se 49.99%, 2 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është 50% - 99.99%, 4 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është 100%. 	ZKA
5	Raportimi i Kryetarit të Komunës para Kuvendit Komunal	2	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është 50%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 75%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 100%. 	SMPK 2.3.4
II	Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve	12	Shuma e treguesëve	
6	Pjesëmarrja e qytetarëve në takime publike, i disagreguar sipas gjinisë	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse mesatarja e dy treguesve e rezultatit në SMPK është më i vogël se 39.99%, 1 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK për është prej 40% - 69.99%, 2 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është prej 70% - 89.99%, 4 pikë nëse mesatarja e dy treguesve në SMPK është e barabartë ose më e madhe se 90%. 	Formulari për pranimin e të dhënave për SMPK
7	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 39.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 40% - 69.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 70% - 89.99%, 4 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	SMPK 2.1.2
8	Seanca dëgjimore publike për KAB dhe buxhetin komunal (proporcionalisht ndaj # banorëve)	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 39.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 40% - 69.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 70% - 89.99%, 4 pikë nëse rezultati në SMPK është më i madh ose barabartë me 90%. 	SMPK 3.1.4
III	Transparenca, qasja në informata dhe integriteti	15	Shuma e treguesëve	
9	Takimet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt	3	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 39.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 40% - 59.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 60% - 89.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	SMPK 2.1.1
10	Përditësimi i rregullt i uebfaqes komunale sipas kërkesave (specifike) ligjore	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 39.99% 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 40% - 59.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 60% - 89.99%, 4 pikë nëse rezultati në SMPK është më e madhe ose barabartë me 90%. 	SMPK 2.2.6
11	Publikimi i dokumenteve dhe kontratave të prokurimit publik	2	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 89.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90% 	SMPK 2.2.2
12	Publikimi i procesverbaleve për proceset e konsultimeve publike	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është më i vogël se 40%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 40-60%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 70-90%, 4 pikë nëse rezultati në SMPK është më e madhe se 90%. 	SMPK 3.1.5
13	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit të paraqitur para Kuvendit Komunal	2	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është më i vogël se 100%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 100%. 	SMPK 2.4.1


ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNj		30	Shuma e nëntemave	
IV	Menaxhimi financiar	13	Shuma e treguesëve	
14	Regjistri i tatimit në pronë i përditësuar çdo vit, sipas kërkesave ligjore	3	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 9.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 10% - 29.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është është i barabartë ose më i madh se 30%. 	Ne dispozicion nga ZKA per 2018
15	Niveli i mbledhjes së tatimit në pronë (pa borxhe, kamata, gjoba)	5	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 39.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 40% - 59.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është 60% - 84.99%, 5 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 85% 	Ne dispozicion nga ZKA per 2018
16	Adresimi i rekomandimeve te auditimit (sipas ZKA)	5	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 29.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 30% - 49.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 84.99%, 5 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 85%. 	Ne dispozicion nga ZKA per 2018
V	Menaxhimi i kontratës	7	Shuma e treguesëve	
17	Zbatimi i planit të prokurimit	3	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 59.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 60% - 89.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	Ne dispozicion nga ZKA per 2018
18	Hartimi dhe publikimi i listës së pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim dhe të shkëmbehen	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 50%, 4 pikë nëse rezultati në SMPK është 100%. 	SMPK 19.1.2
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	10	Shuma e treguesëve	
19	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj	2	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 89.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	SMPK 3.3.2
20	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet e arsimit, shëndetësisë, kulturës	5	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 79.99%, 5 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 80%. 	SMPK 16.1.2
21	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	3	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 29.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 30% - 49.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është është i barabartë ose më i madh se 50%. 	SMPK 3.1.5


III. OFRIMI I SHËRBIMEVE - Qasja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve - Sipas sektorit		30	Shuma e nëntemave	
VII	Shërbimet administrative	6	Shuma e treguesëve	
22	Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 69.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 70% - 89.99%, 4 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	SMPK 1.1.2
23	Kërkesat e shqyrtuara për leje të ndërtimit	2	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është më i vogël se 70%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është mbi 70% 	SMPK 7.2.1
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	8	Shuma e treguesëve	
24	Shtrirja e territorit komunal të përfshirë në planet (e hollësishtme) rregullative	3	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 29.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 30% - 69.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është është i barabartë ose më i madh se 70%. 	SMPK 6.1.1
25	Vendbanimet e mbuluara me transport publik lokal	3	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 79.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 80%. 	SMPK 9.1.2
26	Niveli i zbatimit të veprimit për planin lokal të veprimit për mjedisin	2	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 90% 2 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	SMPK 14.1.1
IX	Arsimi para-universitar	8	Shuma e treguesëve	
27	% e fëmijëve që ndjekin kopshtin	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 79.99%, 4 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 80%. 	SMIA 17.1.2
28	Rezultatet në test të maturës	4	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 2 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 89.99%, 4 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	SMIA 17.1.6
X	Kujdesi parësor shëndetësor	8	Shuma e treguesëve	
29	Hapësira të KPSH në m2 për 10,000 banorë	3	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 49.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 50% - 89.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	SMPK 18.1.1
30	Niveli i përmbushjes së raportit 1 mjek familjar dhe 2 infermiere për 2,000 banorë	5	<ul style="list-style-type: none"> 0 pikë nëse rezultati në SMPK është deri në 29.99%, 1 pikë nëse rezultati në SMPK është 30% - 59.99%, 3 pikë nëse rezultati në SMPK është 60% - 89.99% 5 pikë nëse rezultati në SMPK është i barabartë ose më i madh se 90%. 	SMPK 18.1.3
Total piket		100		

Shtojca IV Vlerësimi i Performancës Komunale nga komunitat, MAPL-ja dhe ZKA-ja


Grafiku 2: Komuna e Obiliqit




Grafiku 3: Komuna Skenderajt



Grafiku 4: Komuna e Gjilanit



Grafiku 5: Komuna e Graçanicës



Ngjyra portokalli në grafik paraqet vlerësimin nga MAPL, ngjyra e kaltër e errët vetëvlerësimin nga komuna dhe ngjyra e kuqe e errët paraqet vlerësimin nga ZKA-ja. Zero në fund të secilës ngjyrë të kaltër paraqet vlerësimin nga ZKA-ja për treguesin përkatës, ndërsa aty ku nuk paraqitet zero dhe as ngjyra e kuqe e errët, kishe kufizim të fushë veprimit për shkak të dhënave të pa qasshme.

Shtojca V Letër konfirmimet



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 06.03.2024

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:


- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të performancës **“Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


Elbert Krasniqi

Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:
Skenderaj 24.01.2024


I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari i K. se Skenderajt
z. Fadil Nura



	ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА KOMUNA E GRAÇANICËS MUNICIPALITY OF GRACANICA	
---	--	---

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.


Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit Vendi dhe data: Gračanica, 06.02.2024.

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

 **Prof.dr Ljiljana Šubarić**
Kryetarja e Komunës së Gračanicës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE - MUNICIPAL GJILAN - GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Gjiçan 06.02.2024

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020” (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari Komunes së Gjiçani
Alban Hyseni



Shtojca VI Komentet e Komunës së Obiliqit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA OBILIQ - OPštINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-104-02-6798-24

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date 06.03.2024

OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

06.03.2024, Obiliq

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “**Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020**” (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- Prandaj rreth të gjeturave dhe rekomandimeve, ne si komunë nuk pajtohemi dhe për këtë ju lutem gjeni të bashkangjitur;
 - Tabelen e komenteve;





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Auditimi i kryer: “Procesi i Dokumentimit, Vlerësimit dhe Verifikimit në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale për vitin 2020”

Dokumenti: Komentet nga institucioni i audituar në raportin e auditimit

Te gjeturat	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Komuna e Obiliqit	Pikëpamja e ZKA-së
3.1.1 Transparenca Komunale	Jo	Lidhur me të gjeturën e parë e cila është emërtuar ne draft-raport si 3.1.1 Transparenca Komunale , komuna e Obiliqit gjatë fazës së raportimit të performancës për vitin 2020 i ka raportuar të dhënat duke u bazuar në dokumentin kryesor, mirëpo disa të dhëna nuk janë kuptuar saktë nga komisioni për raportim dhe të njëjtat të dhëna gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) nga ana e MAPL-së përmes kërkesës për verifikim i kemi plotësuar me dokumentet e nevojshme dhe rezultatet përfundimtare janë shpallur duke u bazuar në verifikimin e lartcekur.	Në faqen 4 të raportit të auditimit, në fusnotë është sqaruar saktë se cilët tregues dhe cilat të dhëna nuk janë mbështetur me dëshmi relevante.

		<p>Ndërsa sa i përket gjetjes lidhur me vegzat e ueb-faqes se komunës te cilat nuk janë të qasshme, ne si komunë vazhdimit kemi pasur probleme me ueb-faqen e cila bazuar në rregullativen në fuqi menaxhohen nga MAPL, problemet janë të vazhdueshme ato janë prezente edhe sot ku në vitet 2019, 2020, 2021, 2022 kemi të dhëna të shumta të cilat mungojnë, të cilat kohë pas kohe janë fshirë nga serverët e ueb-faqes dhe arsyet nuk i dijm as ne si komunë, të njëjtat vegza kanë qenë aktive në kohën e raportimit përkatësisht vlerësimit nga ana e ministrisë.</p>	
<p>3.1.2 Planifikim Hapësinor</p>	jo	<p>Lidhur me të gjeturën e parë e cila është emërtuar ne draft-raport si 3.1.2 Planifikim Hapësinor, komuna e Obiliqit gjatë fazës së raportimit të performancës për vitin 2020 i ka raportuar të dhënat duke u bazuar në dokumentin kryesor, mirëpo disa të dhëna nuk janë kuptuar saktë nga komisioni për raportim dhe të njëjtat të dhëna gjatë fazës së verifikimit nga ana e MAPL-së përmes kërkesës për verifikim i kemi plotësuar me sqarimet e nevojshme dhe rezultatet përfundimtare janë shpallur duke u bazuar në verifikimin e lartcekur.</p> <p>Ndërsa sa i përket gjetjes lidhur me raportin e kryetarit pas plotësimit te sqarimeve nga ana e koordinatorit të njëjtat të dhëna janë pranuar nga</p>	<p>Në Komunën e Obiliqit, nga katër treguesit e kësaj fushe, njëri nga ta nuk është në dispozicion në faqen zyrtare elektronike të komunës (përveç dëshmisë për hartën zonale e cila nuk mund të ngarkohet në sistem), ndërsa kërkesat e tjera nuk janë të mbështetura me dëshmi relevante, siç edhe është raportuar.</p>

		komisioni vlerësues dhe janë pjesë përbërëse e raportit përfundimtar te performancës.	
3.1.3 Infrastruktura rrugore	Jo	<p>Lidhur me të gjeturën e parë e cila është emërtuar ne draft-raport si 3.1.3 Infrastruktura rrugore, komuna e Obiliqit gjatë fazës së raportimit të performancës për vitin 2020 i ka raportuar të dhënat duke u bazuar në dokumentin kryesor, mirëpo disa të dhëna nuk janë kuptuar saktë nga komisioni për raportim dhe të njëjtat të dhëna gjatë fazës së verifikimit nga ana e MAPL-së përmes kërkesës për verifikim i kemi plotësuar me sqarimet e nevojshme dhe rezultatet përfundimtare janë shpallur duke u bazuar në verifikimin e lartcekur.</p> <p>Ndërsa sa i përket gjetjes lidhur me kontratat, fatura dhe pranimi teknik, gjatë fazës së verifikimit të njëjtat dokumente janë bashkëngjitur e cila dëshmohet me kërkesën për verifikim.</p>	Edhe pas procesit të verifikimit për treguesit e përmendur, ne nuk kemi gjetur dëshmi se këta tregues janë mbështetur me kontratë, raport të pranimi teknik dhe pagesa për punët e kryera (sipas kërkesës së dokumentit kryesor f168).
3.1.4 Parkingjet Publike	Jo	Lidhur me të gjeturën e parë e cila është emërtuar ne draft-raport si 3.1.4 Parkingjet Publike , komuna e Obiliqit gjatë fazës së raportimit të performancës për vitin 2020 i ka raportuar të dhënat duke u bazuar në dokumentin kryesor, mirëpo disa të dhëna nuk janë kuptuar saktë nga komisioni për raportim dhe të njëjtat të dhëna gjatë fazës së verifikimit nga ana e MAPL-së përmes kërkesës për verifikim i kemi plotësuar me	Ky auditim ka vlerësuar mbështetjen e të dhënave me dëshmi. Kërkesat për dëshmitë relevante janë të përcaktuara me Dokumentin Kryesor, prandaj çdo dëshmi e cila nuk ishte në përputhje me këto kërkesa, është konsideruar si jo relevante.

		<p>sqarimet e nevojshme dhe rezultatet përfundimtare janë shpallur duke u bazuar në verifikimin e lartcekur.</p> <p>Ndërsa sa i përket gjetjes lidhur me kontratë koncesionale të komunës me partner privat, leje të lëshuara për ofrimin e shërbimit të parkimit publik dhe regjistrat e mjeteve motorike, konstatojmë se komuna e Obiliqit ka vetëm parkingje publike të cilat menaxhohen nga komuna dhe janë dëshmuar përmes raportit të komisionit, të dhëna të cilat janë pranuar nga komisioni vlerësues nga MAPL dhe janë pjese e raportit final të performancës.</p>	
3.1.5 Uji i Pijshëm	Jo	<p>Lidhur me të gjeturën e parë e cila është emërtuar ne draft-raport si 3.1.5 Uji i Pijshëm, të dhënat janë të bashkëngjitura në sistem, raporti nga Ujësjiellësi Rajonal Prishtina si dhe raporti nga ASK lidhur me gjendjen e ekonomive familjare në komunë.</p> <p>Sa i përket referencave të faqeve sipas dokumentit kryesor nuk kemi obligim të japin edhe referenca lidhur se ku gjenden saktësisht të dhënat, mirëpo të dhënat me një kërkim të vogël “Obiliq” janë lokalizuar me lehtësi.</p>	Në këtë fushë ne nuk kemi gjetur dëshmi siç i kërkon Dokumenti Kryesor (kontratë për punë të kontraktuara në rrjetin e ujësjiellësit dhe raportet zyrtare dhe të protokolluara për realizimin e punëve) as për deklarimin fillestar të komunës, e as për procesin e verifikimit.
3.1.6 Kujdesi Primar Shëndetësor,	Jo	<p>Lidhur me të gjeturën e parë e cila është emërtuar ne draft-raport si 3.1.6 Kujdesi Primar Shëndetësor, për komunën është e pakuptueshme se cilët tregues të kësaj fushe mungojnë dëshmitë e kërkuara, nëse bëhet fjalë për treguesin 18.1.2,</p>	Dy nga shtatë treguesit e performancës komunale në këtë fushë nuk ishin mbështetur me dëshmitë e duhura, pra mungojnë raportet nga qendrat e mjekësisë

		duke pasur parasysh që e dhëna një emërtohet <i>Gjithsej numri i njësive të mjeksisë familjare të cilat përmbushin kërkesat për inventar, mjete, dhe ofrimin e shërbimeve laboratorike</i> ne i kemi raportua të gjitha qendrat e mjekësisë familjare që i posedojnë inventarin dhe mjetet e nevojshëm dhe e kemi sqaruar se shërbimin e laboratorit e ofron vetëm Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, dhe gjatë verifikimit kjo e dhënë është përmirësuar.	familjare si dhe raportimet në inspektoratin shëndetësor.
3.1.7 Zhvillim Ekonomik Lokal	Jo	Lidhur me të gjeturën e parë e cila është emërtuar ne draft-raport si 3.1.7 Zhvillim Ekonomik Lokal , sa i përket mbështetjes pjesërisht me dokumente është e pa qartë për komunën e Obiliqit se cilat dokumente mungojnë, kur nga ana e ministrisë të dhënat lidhur me këta tregues verifikohen përmes ministrisë së financave (Sistemi ProTax), ndërsa sa i përket mungesës së qasjes në vegzën ashtu siç e potencuam edhe më lart ueb-faqet e komunave janë nën përgjegjësinë e ministrisë, në mund të ju sigurojmë që në kohën e raportimit vegza ka qenë aktive dhe e qasshme ndërsa pse nuk ka qasje tani pas 3 viteve nuk mund të marrim përgjegjësi, mirëpo e keni pjesë përbërëse të këtij dokumenti.	Në të gjitha rastet ku ekipi i auditimit nuk kishte qasje në dëshmi (qoftë sistem apo ueb faqe), ne nuk kemi mundur të vlerësojmë, prandaj edhe është potencuar se treguesit e tillë nuk janë vlerësuar. Ky është njëri nga ato raste, ku vlerësimi ishte i pamundur.
3.2 Dokumentimi i treguesve nga komunat për Grant të	Jo	Lidhur me pikën 3.2 Dokumentimi i treguesve nga komunat për Grant të Performancës Komonale në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19 dhe probleme tjera komunat kanë raportuar për 102 tregues nga gjithsej 119, dhe dy tregues përkatësisht treguesit 3.5.2 dhe 17.3.1 të cilët janë edhe tregues të Grantit të Performancës	

<p>Performancës Komunale</p>		<p>komunat nuk kanë raportuar fare dhe rrjedhimisht në sistem shfaqet vlera zero e raportimit.</p> <p>Sa i përket 28 treguesve tjerë të Grantit në bazë të të cilëve Komuna e Obiliqit ka përfituar Grantin do ju shtjellojmë më poshtë gjendjen reale dhe faktike e dëshmuar me dokumentacionin e nevojshëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Treguesi: 3.2.1 Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 100%. Vlerësimi me JO nga ekipi i auditimit nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) është përmirësuar ky tregues. 2. Treguesi: 3.2.2 Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 100%. Vlerësimi me Pjesërisht nga ekipi i auditimit nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) është përmirësuar ky tregues. 3. Treguesi: 3.2.3 Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak – Në këtë tregues Komuna e Obiliqit dhe asnjë komunë tjetër nuk ka mundur të raportoj 	<p>Dokumentet e bashkangjitura nuk janë në datat e kërkuara sipas Dokumentit Kryesor. E dhëna 1 “dorëzimi i buxhetit nga Kryetari i Komunës tek Kuvendi Komunal para datës 1 shtator” është dorëzuar me datën 16 shtator;</p> <p>e dhëna 2 “Miratimi nga Kuvendi i Komunës para datës 30 shtator” është bërë me datën 29 tetor.</p> <p>Arsyeja e vlerësimit me 50 pikë është sepse dy raporte (janar dhe shtator) janë konfrom kërkesave, ndërsa raporti i shkurtit nuk është dokument valid dhe mungojnë raportet e maujit mars dhe dhjetor.</p> <p>Në këtë raport janë prezantuar me 0 ata tregues të cilet nuk jane vlerësuar as nga ZKA.</p>
-------------------------------------	--	--	--

		<p>fare sepse ka qenë tregues i ngrirë. Vlerësimi me 0 nga ekipi i auditimit nuk qëndron, sepse si pasojë e vonesës së vlerësimit të performancës nga ana e MAPL-së komunat nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin ligjor që ka qenë 30 shtatori për ta diskutuar raportin e performancës në Kuvendin Komunal dhe për këtë arsye është ngrirë si tregues për vitin 2020.</p> <p>4. Treguesi: 3.2.4 Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Asamblenë Komunale - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 100%. Pas verifikimit nga ekipi i auditimit kërkojmë që edhe ky tregues të vlerësohet me PO në draft raportin e dorëzuar.</p> <p>5. Treguesi: 3.2.5 Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale - Në këtë tregues ne si komunë kemi raportuar me 0 sepse nuk është diskutuar i njëjti raport në Kuvendin Komunal dhe rrjedhimisht edhe në Grantin e Performancës lidhur me këtë tregues ne nuk kemi marr pikë.</p> <p>6. Treguesi: 3.2.6 Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës - Në</p>	<p>Ky tregues nga ana e ZKA-së është vlerësuar me 50, pikë pasi që mungon plani i verimit për zbatimin e rekomandimeve.</p> <p>Në raport e kemi prezantuar si të tillë, pra që është raportuar me 0 edhe nga komuna.</p> <p>Mbledhjet me prezencë të kryetarit janë gjashte, ndërsa numri i mbledhjeve të</p>
--	--	---	---

		<p>këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 69,23%. Vlerësimi me Pjesërisht nga ekipi i auditimit nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit është përmirësuar ky tregues.</p> <p>7. Treguesi: 3.1.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 19,49%. Vlerësimi me Pjesërisht nga ekipi i auditimit nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit është përmirësuar ky tregues, vlen të theksohet se në këtë tregues për shkak të ndikimit të pandemisë COVID-19 nuk kemi marr pikë në grant sepse pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë shumë e ulët.</p> <p>8. Treguesi: 3.1.3 Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 50% Vlerësimi me JO nga ekipi i auditimit nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) është përmirësuar ky tregues.</p>	<p>rregullta dhe të jashtë zakonshme është 13, pra ky tregues është vlerësuar me 46%, që do të thotë se është mbështetur pjesërisht me dëshmi.</p> <p>Ndryshimet janë reflektuar në raport.</p> <p>Ne fazën e deklarimit fillestar Komuna ka bashkëngjitur raportin vjetor të Kryetarit të Komunës dhe raportin vjetor të Kuvendit Komunal, ndërsa në fazën e verifikimit ne nuk gjejmë dëshmi shtesë që ndryshon rezultatin e treguesit. Dokumentet e lartëpërmendura nuk janë relevante për këtë tregues.</p>
--	--	---	---

		<p>9. Treguesi: 2.1.1 Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 15.38% Vlerësimi me Pjesërisht nga ekipi i auditimit nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) është përmirësuar ky tregues.</p> <p>10. Treguesi: 2.1.3 Përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës – Në këtë tregues komuna e Obiliqit ka raportuar në mënyrë të plotë dhe në pajtim me dokumentin kryesor, nuk e kuptojmë se përse është vlerësuar nga ekipi i auditimit vetëm me Pjesërisht dhe rrjedhimisht nuk pajtohem me vlerësimin e njëjtë.</p> <p>11. Treguesi: 3.1.5 Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike – Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar, ashtu si raportimi edhe vlerësimi është poentuar me zero, Komuna e Obiliqit nuk pajtohet me konstatimin e ekipes së auditimit që nuk kemi raportuar fare sepse në këtë tregues kemi raportuar dhe vlerësimi është zero, andaj të njëjtin vlerësim me 0 nuk e pranojmë dhe kërkojmë që të përmirësohet nga ekipi i auditimit.</p>	<p>Ndryshimet janë reflektuar në raport.</p> <p>Ndryshimet janë reflektuar në raport.</p> <p>Në deklarinimin fillestar Komuna ka raportuar me zero, rrjedhimisht edhe MAPL dhe ZKA e kanë vlerësuar me zero. Ndërsa sa i përket procesit të verifikimit për këtë tregues, për ne nuk kemi gjetur dëshmi që kishte dëshmi shtesë.</p>
--	--	--	--

		<p>12. Treguesi: 3.4.1 Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar, ashtu si raportimi edhe vlerësimi është poentuar me zero, Komuna e Obiliqit nuk pajtohet me konstatimin e ekipes së auditimit që nuk kemi raportuar fare sepse në këtë tregues kemi raportuar dhe vlerësimi është zero, andaj të njëjtin vlerësim me 0 nuk e pranojmë dhe kërkojmë që të përmirësohet nga ekipi i auditimit.</p> <p>13. Treguesi: 19.1.3 Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar, ashtu si raportimi edhe vlerësimi është poentuar me 24.56%. Ndërsa sa i përket mungesës së qasjes në vegzën ashtu siç e potencuam edhe më lart ueb-faqet e komunave janë nën përgjegjësinë e ministrisë, në mund të ju sigurojmë që në kohën e raportimit vegza ka qenë aktive dhe e qasshme ndërsa pse nuk ka qasje tani pas 3 viteve nuk mund të marrim përgjegjësi.</p> <p>14. Treguesi: 3.3.3 Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar, Komuna e Obiliqit nuk pajtohet me konstatimin e ekipes së auditimit që kemi dokumentuar vetëm pjesërisht sepse gjatë fazës së verifikimit nga ana e MAPL-së është përmirësuar vlera</p>	<p>Në deklarinimin fillestar Komuna ka raportuar me zero, rrjedhimisht edhe MAPL dhe ZKA e kanë vlerësuar me zero.</p> <p>Në të gjitha rastet ku ekipi i auditimit nuk kishte qasje në dëshmi (qoftë sistem apo ueb faqe), ne nuk kemi mundur të vlerësojmë, prandaj edhe është potencuar se treguesit e tillë nuk janë vlerësuar. Ky është njëri nga ato raste, vlerësimi ku ishte i pamundur.</p> <p>Komuna gjatë raportimit për këtë tregues kishte raportuar se ka zbatuar 8 nga 11 rekomandimet e dhëna nga ZKA. Njëjtë është vlerësuar edhe nga ekipi auditimit i vitit</p>
--	--	---	---

		<p>e raportuar dhe dokumentet janë të bashkëngjitura, andaj të njëjtin vlerësim me Pjesërisht nuk e pranojmë dhe kërkojmë që të përmirësohet nga ekipi i auditimit.</p> <p>15. Treguesi: 19.1.2 Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim – Në këtë tregues Komuna ka Raportuar në pajtim me dokumentin kryesor ku ka bashkëngjitur vegzën e ueb-faqes se Listës së Pronave të Planifikuara për dhënie në shfrytëzim sepse është kriter i performancës të jetë publike për të gjithë ndërsa pse nuk kemi qasje në vegzën e bashkëngjitur e kemi theksuar më lartë problemin e ueb-faqeve të komunave të Republikës të cilat janë nën përgjegjësinë e MAPL-së.</p> <p>16. Treguesi: 16.1.2 Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 87.27%.Vlerësimi me JO nga ekipi i auditimit nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) është përmirësuar ky tregues.</p> <p>17. Treguesi: 16.1.3 Gratë e emëruara në pozita politike në komunë - Në këtë</p>	<p>vijues. Mirëpo 8/11 është 72.7% dhe jo 85.71% siç e ka raportuar Komuna.</p> <p>Në të gjitha rastet ku ekipi i auditimit nuk kishte qasje në dëshmi (qoftë sistem apo ueb faqe), ne nuk kemi mundur të vlerësojmë, prandaj edhe është potencuar se treguesit e tillë nuk janë vlerësuar. Ky është njëri nga ato raste, vlerësimi ku ishte i pamundur.</p> <p>Dokumenti i bashkëngjitur në procesin e verifikimit është i pavulosur dhe pa protokolluar, pra nuk është në përputhje me kërkesat e Dokumentit Kryesor, për më tepër nuk kishte detaje rreth emrave.</p>
--	--	--	--

		<p>tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 87.27%. Vlerësimi me Pjesërsiht nga ekipi i auditimit nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) është përmirësuar ky tregues.</p> <p>18. Treguesi: 1.1.2 Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar, ashtu si raportimi edhe vlerësimi është poentuar me 93.83%, Komuna e Obiliqit nuk pajtohet me konstatimin e ekipes së auditimit Tregues i Ngrirë gjatë vlerësimit sepse ne kemi raportuar dhe vlerësuar në pajtim me dokumentin kryesor andaj vlerësimin e ekipit së auditimit nuk e pranojmë dhe kërkojmë që të përmirësohet nga ekipi i auditimit.</p> <p>19. Treguesi: 15.1.2 Lejet mjedisore komunale të lëshuara - Në këtë tregues ne si komunë kemi raportuar në pajtim me dokumentin kryesor ku jemi vlerësuar nga MAPL ashtu siç kemi raportuar dhe të dhënat janë të ngarkuara në sistem, dhe i njëjti tregues nuk bënë pjesë në treguesit e Grantit të Performancës, andaj kërkojmë nga ekipi i auditimit t'i përmirësoj të dhënat ashtu siç i kemi raportuar.</p>	<p>Ndryshimet janë reflektuar në raport meqë janë mbështetur me vendimet përkatëse.</p> <p>Për treguesit e ngrirë janë reflektuar ndryshimet në raport.</p> <p>Në të gjitha rastet ku ekipi i auditimit nuk kishte qasje në dëshmi (qoftë sistem apo ueb faqe), ne nuk kemi mundur të vlerësojmë, prandaj edhe është potencuar se treguesit e tillë nuk janë vlerësuar. Ky është njëri nga ato raste, vlerësimi ku ishte i pamundur.</p>
--	--	---	--

		<p>20. Treguesi: 7.1.1 Sipërfaqja e territorit të komunës i mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme) – Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar, ashtu si raportimi edhe vlerësimi është poentuar me 0%, Komuna e Obiliqit nuk pajtohet me konstatimin 0 na ekipa e auditimit sepse në këtë tregues nuk kemi bashkëngjitur dokumentin e kërkuar sepse në vitin 2020 Komuna e Obiliqit përveq Planit Zhvillimor Komunal nuk ka pasur Plane Rregulluese të Hollësishme e as Harta Zonale, andaj vlerësimin e ekipit së auditimit nuk e pranojmë dhe kërkojmë që të përmirësohet nga ekipi i auditimit.</p> <p>21. Treguesi: 10.1.2 Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar, ashtu si raportimi edhe vlerësimi është poentuar me 24.56%, Komuna e Obiliqit nuk pajtohet me konstatimin e ekipes së auditimit që nuk ka pasur dëshmi fare sepse dëshmitë janë në sistem, andaj të njëjtin vlerësim me Të dhëna të pa qasshme dhe kërkojmë që të përmirësohet nga ekipi i auditimit.</p> <p>22. Treguesi: 10.1.1 Realizimi i planit komunal për transport lokal publik - Në këtë tregues Komuna e Obiliqit gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) i ka përcjellë të gjitha dokumentet e kërkuara nga MAPL për këtë arsye është vlerësuar me 0%. Vlerësimi me JO nga ekipi i auditimit</p>	<p>Siç edhe keni pohuar me koment që dokumentet nuk ishin në përputhje me kërkesat, ZKA ka vlerësuar me zero.</p> <p>Në të gjitha rastet ku ekipi i auditimit nuk kishte qasje në dëshmi (qoftë sistem apo ueb faqe), ne nuk kemi mundur të vlerësojmë, prandaj edhe është potencuar se treguesit e tillë nuk janë vlerësuar. Ky është njëri nga ato raste, vlerësimi ku ishte i pamundur.</p> <p>Kërkesa e Dokumentit Kryesor është që të bashkëngjitet Plani i transportit publik. Kjo dëshmi nuk është bashkëngjitur, prandaj edhe është vlerësuar me zero.</p>
--	--	--	--

		<p>nuk qëndron dhe nuk pajtohem me të sepse gjatë fazës së verifikimit (konsultimit paraprak) është përmirësuar ky tregues, po ashtu i njëjti tregues nuk bënë pjesë në treguesit e Grantit të Performancës.</p> <p>23. Treguesi: 17.3.5 Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë) – Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar në pajtim me Dokumentin Kryesor të dhënat për numrin e nxënësve janë të evidentuara në Raportin e Drejtorisë së Arsimit dhe në sistemin SMIA, komuna nuk pajtohet me vlerësimin Të dhëna të pa qasshme nga ekipi i auditimit andaj kërkojmë që të përmirësohet.</p> <p>24. Treguesi: 18.1.1 m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë – Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar në pajtim me Dokumentin Kryesor të dhënat për m2 të hapësira QKMF, QMF dhe AMF janë në Strategjinë e Drejtorisë së Shëndetësisë e cila është e bashkëngjitur në sistemin, komuna nuk pajtohet me vlerësimin Të dhëna të pa qasshme nga ekipi i auditimit sepse të dhënat janë në sistem, andaj kërkojmë që të përmirësohet.</p> <p>25. Treguesi: 18.2.1 Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë – Në këtë tregues Komuna e Obiliqit ka raportuar në</p>	<p>Në të gjitha rastet ku ekipi i auditimit nuk kishte qasje në dëshmi (qoftë sistem apo ueb faqe), ne nuk kemi mundur të vlerësojmë, prandaj edhe është potencuar se treguesit e tillë nuk janë vlerësuar. Ky është njëri nga ato raste, vlerësimi ku ishte i pamundur.</p> <p>Në të gjitha rastet ku ekipi i auditimit nuk kishte qasje në dëshmi (qoftë sistem apo ueb faqe), ne nuk kemi mundur të vlerësojmë, prandaj edhe është potencuar se treguesit e tillë nuk janë vlerësuar. Ky është njëri nga ato raste, vlerësimi ku ishte i pamundur.</p> <p>Në të gjitha rastet ku ekipi i auditimit nuk kishte qasje në dëshmi (qoftë sistem apo ueb faqe), ne nuk kemi mundur të vlerësojmë,</p>
--	--	---	---

		<p>pajtim me Dokumentin Kryesor dhe duke pasur parasysh që e dhëna një emërtohet <i>Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë</i> ne kemi raportuar lidhur me këtë tregues duke u bazuar në Dokumentin Kryesor të dhënat lidhur me këtë tregues janë në raportin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe në Strategjinë e saj, andaj të njëjtin vlerësim me Të dhëna të pa qasshme nga ekipi i auditimit sepse të dhënat janë në sistem, andaj kërkojmë që të përmirësohet.</p> <p>PËRFUNDIM</p> <p>Duke u bazuar në të dhënat e cekura më lart Komuna e Obiliqit me shumë respekt për Zyrën Kombëtare të Auditimit, përkatësisht ekipin audituese të performancës për vitin 2020, kërkon nga ju që të ri-shikohet draft-raporti i dërguar me datë 04.03.2024, të përmirësohen të gjithë treguesit të cilat janë poentuar me zero, po ashtu të përmirësohet edhe përshkrimi i të gjeturave, ku në shumë tregues theksohet se “në shumë prej treguesve nuk janë mbështetur në dëshmi relevante, linqe të pas qasshme” (linqet në kohën e raportimit ka pasur qasje), sepse të njëjtat i kemi sqaruar më lartë dhe për më shumë e keni dëshminë e verifikimit pas raportimit.</p>	<p>prandaj edhe është potencuar se treguesit e tillë nuk janë vlerësuar. Ky është njëri nga ato raste, vlerësimi ku ishte i pamundur.</p>
--	--	--	---

